



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Drejtësi

PROCESVERBAL

Tiranë, më 23.09.2016, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Vazhdimi i diskutimit rreth projektligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Pandeli Majko, Vasilika Hysi, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Keltis Kruja, Fatmir Mediu, Spartak Braho.

Të ftuar:

Gent Ibrahimimi - Ekspert i Nivelit të Lartë

Agnes Bernhard – Eksperte e Nivelit të Lartë

Albana Shtylla – Koordinatore e Përgjithshme, Zyra e Sekretariatit Teknik.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj - Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Posaçëm parlamentar për Reformën në Drejtësi. Fillimisht do të miratojmë procesverbalet e mbledhjeve të mëparshme. Dakord.

Sot në rendin e ditës kemi vazhdimin e diskutimit të projektligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, mbi të cilin janë bërë një sërë ndryshimesh për efekt të ndryshimeve kushtetuese, ndryshimeve në kuadrin tjetër ligjor të fushës, të ligjeve që kemi kaluar, por edhe për të reflektuar efektin e mundshëm financiar, nivelin e pagave në konsultim me Ministrinë e Financave dhe me Departamentin e Administratës Publike. Kështu jemi të detyruar t’i marrim një për një dhe t’i shohim reflektimet përkatëse.

Relatore e këtij projektligji është zonja Hysi. Kështu që së bashku do të vazhdojmë shqyrtimin nen për nen. U lutem ekspertëve të jenë të vëmendshëm për ndonjë ndërhyrje të mundshme.

Vazhdojmë me nenin 1 “Objekti i ligjit”?

Vasilika Hysi – Nuk ka probleme.

Fatmir Xhafaj – Ky është drafti i datës 13 shtator, kështu që besoj se e kanë të gjithë kolegët e maxhorancës dhe të opozitës.

Neni 1 mbetet siç është në dokument.

Neni 2 “Përkufizime”?

Vasilika Hysi - Në nenin 2 janë reflektuar disa sugjerime. Unë sugjeroj që neni 2 të renditet sipas rendit alfabetik dhe disa pika kanë nevojë për redaktime.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, neni 2 germa “nj” ka një devijim nga të gjitha rregullat standarde të ligjeve të tjera. “Funksionarët politikë në administratën publike” ne kemi një përkufizim tashmë të pranuar në të gjitha ligjet, kurse në këtë ligj bëhet një përjashtim.

Fatmir Xhafaj – Ku është?

Vasilika Hysi – Te “Përkufizimet” në fund. Pra, kanë përjashtuar çdo këshilltar ligjor në Ministrinë e Drejtësisë. Për këta nuk ka pengesa nëse janë funksionarë politikë.

Agnes Bernhard – *(Flet përkthyesja)* Ideja ishte që të përfshiheshin përkufizimet e ligjit për vlerësimin dhe jo të ligjit ekzistues.

Fatmir Xhafaj – Me këtë ne bëjmë përjashtim nga rregullimi i ligjit të vetingut.

Agnes Bernhard – (*Flet për kthyesja*) Do ta heqim këtë pjesë dhe do ta zëvendësojmë me përkufizimet e ligjit për vlerësimin.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Kini parasysh kur themi “strukturat juridiko-profesionale” normal që do të jenë ata që punojnë në drejtori, sepse mund të vijnë magjistratë dhe të punojnë në ministri në kodifikim. Për efekt të kësaj kjo do të konsiderohet, por vetëm ata që punojnë në kabinetin e ministrisë, që të jemi të qartë.

Faleminderit për ndryshimin!

Neni 3 “Vlerat themelore?”

Vasilika Hysi - Në rregull.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Neni 4 “Standardet etike dhe rregullat e sjelljes”?

Vasilika Hysi - Këtu janë bërë disa formulime terminologjike.

Fatmir Xhafaj - Dakord me redaktimet.

Neni 5 “Të drejtat dhe detyrimet për formimin vazhdues”?

Vasilika Hysi - Edhe këtu janë bërë disa formulime dhe janë përshtatur me ligjin “Për organet e qeverisjes”.

Fatmir Xhafaj - Dakord me këto ndryshime, që janë kryesisht teknike dhe redaktoriale.

Neni 6 “Papajtueshmëritë”?

Vasilika Hysi - Këtu është bërë plotësimi i titullit të nenit “Papajtueshmëritë në funksionet e magjistratit”.

Fatmir Xhafaj - Në rregull.

Neni 7 “Kufizimet për shkak të funksionit”?

Vasilika Hysi - Këtu janë bërë redaktime terminologjike.

Fatmir Xhafaj - Dakord.

Neni 8 “Papajtueshmëria ambientale”?

Vasilika Hysi - Lidhur me termin “Papajtueshmëria ambientale”, kemi pasur një diskutim. Është një shqetësim që e keni ngritur ju, zoti kryetar, nëse mund të përdoret një term tjetër apo jo.

Fjala është për papajtueshmëri për shkak të lidhjeve familjare, të lidhjeve të gjakut. Unë sugjeroj që paragrafi 1 të rregullohet, të përmirësohet, pasi rregullat për SPAKU-n janë të përcaktuara në ligjin “Për SPAKU-n”. Pra, nuk mundemi ne në këtë ligj të përcaktojmë

faktin që po të jenë nën 15 magjistratë në SPAK mund të punojnë edhe burrë e grua e të tjerë. Prandaj, kërkoj që paragrafi 1 të riformulohet dhe germa “g” e paragrafit 1 të qëndrojë në ligj ashtu siç ka qenë.

Pra, në këtë ligj është bërë një diferencim: në gjykatat më me pak se 15 magjistratë ndalohet të punojnë bashkë njerëz me lidhje gjaku, por po të ketë mbi 15 magjistratë mund të punojnë bashkë edhe burrë e grua, motër e vëlla e të tjerë. Ky është një konflikt i pastër interesi.

Këtë gjë e kemi diskutuar edhe dje me zonjën Agnes dhe kemi rënë dakord që lidhur me funksionimin e Gjykatës së Posaçme ne nuk mund të përcaktojmë rregulla.

Fatmir Xhafaj – Ne kemi një parim të përgjithshëm: në të gjitha gjykata dhe prokuroritë nuk ka rëndësi nëse janë 5, 50 apo 150 magjistratë lidhjet burrë e grua dhe të afërm nuk duhet të punojnë bashkë. Dy njerëz mund të jenë të martuar brenda një gjykate apo prokurorie, por njëri duhet të ikë nga sistemi.

Vasilika Hysi – Njëkohësisht, ekspertët kanë bërë një sqarim bazuar në shqetësimin që ne kemi ngritur gjatë diskutimit të këtij projektligji se në cilat raste do të quhet konflikt interesi dhe si duhet shmangur kur një pjesëtar i familjes punon në një gjykatë të shkallës së parë dhe një pjesëtar tjetër i familjes punon në një gjykatë Apeli ose njëri punon në gjykatë dhe tjetri në prokurori. Zonja Agnes ka komente lidhur me këtë pjesë.

Fatmir Xhafaj – Këto janë rregulla që i nënshtrohen Kodit të Procedurës Civile dhe Kodit të Procedurës Penale dhe janë të qarta.

Në rregull, neni 8 riformulohet i gjithi dhe hiqen ato gjëra që ramë dakord që të mos jenë.

Neni 9 “Veprimtaritë jashtë funksionit”.

Vasilika Hysi – Neni 9 nuk ka ndryshime, por janë vetëm disa saktësime. Për shembull, në paragrafin 6 është detajuar mënyra se si operon këshilli për marrjen e një kërkesë.

Fatmir Xhafaj – Neni 9 mbetet siç është paraqitur.

Neni 10 “Liria e organizimit dhe liria e shprehjes”?

Këtë mund ta kishit bërë “Liria e organizimit dhe e shprehjes”, sepse dy herë fjala “liria” brenda një titulli nuk shkon.

Dakord me ndryshimin e titullit.

Kreu III “Paga dhe përfitimet e tjera financiare dhe shoqërore”?

Vasilika Hysi – Ky është kreu i parë e konsultuar me Ministrinë e Financave.

Fatmir Xhafaj – I lutem përfaqësueses së Ministrisë së Financave që të ulet këtu pranë, sepse mund të na duhet një reagim i mundshëm nga ana juaj për gjëra që nuk jemi treguar të vëmendshëm.

(Mungesë incizimi.)

Neni 11 “Parimet e caktimit të pagës dhe përfitimeve financiare të magjistratit”?

Albana Shtylla – Këtu është ndryshuar dispozita që ka të bëjë me strukturën e pagës, duke iu referuar strukturës së kërkuar nga Departamenti i Administratës Publike me një pagë bazë, shtesë për funksion; shtesë për vjetërsi dhe më pas për problemet e tjera, të cilat janë parashikuar në dispozitat në vijim.

Fatmir Xhafaj – Domethënë, kjo miratohet sipas konsultimit të Ministrisë së Financave dhe DAP-it?

Albana Shtylla – Po.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, me ndryshimet në nenin 11.

Vazhdojmë me nenin 12 “Caktimi i pagës së magjistratit”?

Albana Shtylla – Për sa i përket nenit 12, këtu është reflektuar paga referuese në vijim të përllogaritjeve që kemi bërë me Ministrinë e Financave për nivelin bazë nga i cili do të llogariten përfitimet për magjistratët. Më pas janë shtesat që do të jepen për funksion apo për vjetërsi.

Fatmir Xhafaj – Në rregull me nenin 12, sipas rakordimeve të bëra nga Ministria e Financave dhe DAP-i.

Neni 13 “Paga magjistratit të komanduar”?

Albana Shtylla - Në rregull.

Fatmir Xhafaj – Neni 14 “Paga e magjistratëve në pozicione drejtuese”?

Albana Shtylla – Siç jam e informuar edhe nga sekretariati teknik, këto komponentë janë në vijim të diskutimeve të bëra në mbledhjen e komisionit të posaçëm. Pra, nuk janë çështje të cilat lidhen me Ministrinë e Financave dhe me DAP-in.

Fatmir Xhafaj - Dakord me ndryshimet.

Neni 15 “Paga e magjistratëve në skemën e delegimit”?

Albana Shtylla – Kompensimi i magjistratëve është parashikuar në nivelin 40%. Kemi pasur diskutime me ekspertët e EURALIUS-it, por propozimi që kemi dhënë është ky që ju keni këtu para.

Fatmir Xhafaj - Dakord me ndryshimet.

Miratohet.

Neni 16 “Shpërblimi për aftësi”?

Albana Shtylla – Është riformular pjesa “çdo magjistrat është vlerësuar për vitin kalendarik paraardhës”.

Fatmir Xhafaj - Dakord me ndryshimet, sipas dakordësimit që është bërë me DAP-in dhe me Ministrinë e Financave.

Neni 17?

Albana Shtylla – Neni 17 ‘Kredia për shtëpi’, të paktën nga diskutimet që kemi bërë dje me zonjën Hysi për vlerën, se e shoh që nuk është reflektuar, vlera e kredisë të mos jetë “të paktën 50 metra katrorë” por “në 50 metra katrorë”.

Fatmir Xhafaj - Dakord me ndryshimet.

Albana Shtylla – Sepse kur thuhet “të paktën 50 metra katrorë”, do të thotë se magjistrati mund të marrë një kredi që i përgjigjet vlerës së një apartamenti nga 50 metra katrorë dhe më shumë. Duke qenë se në diskutimin që është bërë kjo vlerë mund të shkonte më shumë, u vendos që të lihet “në 50 metra katrorë”.

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me nenin 18 “Rregulla të hollësishme për pagat dhe përfitimet e tjera financiare”?

Albana Shtylla – Një sqarim lidhur me shpërblimet për fëmijët. Ky nen është hequr në vijim të diskutimeve që keni pasur në mbledhjen e mëparshme të komisionit të posaçëm dhe nga Ministrinë e Financave është pranuar një gjë e tillë.

Fatmir Xhafaj – Keni gjë lidhur me nenin 18, ish-neni 19 “Rregulla të hollësishme për pagat dhe përfitimet e tjera financiare”? Në rregull.

Neni 19 “Bursa e shkollimit”?

Albana Shtylla – Nuk ka ndonjë ndryshim këtu.

Fatmir Xhafaj – Sipas ndryshimeve që janë bërë që të mos i lexojmë një për një por që janë të dakordësuara me Ministrinë e Financave dhe DAP-in.

Neni 20 “Mbrojtja e veçantë e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij”?

Albana Shtylla – Te neni 20, duke qenë se ka pasur një diskutim me Ministrinë e Financave, me grupin e punës që ka qenë më parë dhe ndërkohë edhe me sugjerimet tuaja, është hequr mbrojtja e veçantë për sa i përket sigurimit të detyrueshëm të jetës e të tjerë me radhë.

Fatmir Xhafaj – Dakord me ndryshimin në nenin 20.

Neni 21 “Pensioni suplementar”?

Albana Shtylla – Ky nen është ndryshuar përsëri në diskutimet me Ministrinë e Financave, me përfaqësuesit e Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Për sa i përket klasifikimit

në drejtim të përfitimeve shtetërore suplementare, është menduar që të ketë një rikategorizim të tyre në një shkallë më të lartë, pra në nivelin e sekretarëve të përgjithshëm në ministri dhe zëvendësministrave. Ndërkohë, kuptohet se do të duhet që të ketë pasqyrime edhe të ligji i pensioneve shtetërore suplementare, por është bërë me referencë të atij ligji dhe është dakordësuar nga ISSH-ja dhe nga Ministria e Financave.

Fatmir Xhafaj - Është normale, që të dakordësohet edhe me sistemin aktual që kemi për pensionet suplementare, por edhe duke dhënë mbështetjen e nevojshme.

Dakord me formulimin dhe ndërhyrjen.

Neni 22 ose ish-neni 27 “Paprekshmëria e pagës dhe të përfitimeve të tjera financiare të magjistratit”?

Dakord me ndryshimet e bëra.

Kreu IV “Leja dhe ulja e kohës së punës”

Neni 23, ish-neni 28 “Pushimet vjetore”?

Në rregull, dakord me ndryshimet.

Neni 24 “Pushimet e tjera”?

Albana Shtylla – Ky nen është përputhur me direktivën europiane, kështu që është në rregull.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Neni 25 “Siguria dhe shëndeti në punë”?

Agnes Bernhard – (*Flet përthyesja*) Kam një sugjerim lidhur me nenin 24, paragrafi 3 dhe 4. Këtu duhet të parashikohet që magjistrati mund të kërkojë leje të papaguar për qëllim kualifikimi, specializimi në një institucion trajnimi, me qëllim që të shmanget abuzimi që mund të marrë leje të papaguar dhe të punojë në një organizatë private.

Në paragrafin 4 duhet të thuhet: “Këshillat mund të japin leje të papaguar” në vend që të thuhet “këshillat duhet të japin leje të papaguar”.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, dakord me sugjerimin, sepse është e vërtetë që mund të ketë edhe abuzimime.

Neni 25 “Siguria dhe shëndeti në punë”?

Dakord me këtë nen.

Neni 26 “Ulja e ngarkesës”?

Petrit Vasili - Më lejoni, ju lutem, se dua të heq një kuriozitet! Ne kemi një seri dispozitash të rregulluara shumë qartësisht. Si ka mundësi të cenohet siguria dhe shëndeti në punë i magjistratëve, sepse ata nuk janë as minatorë, as punëtorë. Si mund të shkruajmë gjithë këtë dispozitë kur ne i kemi ligje të qarta për këtë punë?

Fatmir Xhafaj - Sepse u referohet atyre.

Petrit Vasili – Pse duhet ta bëjmë referencë, ne duhet të bëjmë status se cili është raporti i magjistratëve me punën, me ligjin.

Fatmir Xhafaj - Ka një ligj të posaçëm, është ligji nr. 10237...

Petrit Vasili – Është shumë e vërtetë, por pse duhet ta shënojmë si fakt. Ky nen nuk duhet të ekzistojë fare. Nuk është gjëkundi kjo gjë, sepse dihet që kjo marrëdhënie është rregulluar me atë ligj.

Albana Shtylla – Në fakt, mund të merret në konsideratë ajo që tha zoti Vasili, sepse në nenin 4 të Kodit të Punës thuhet se për çështjet, të cilat nuk rregullohen në ligjin e posaçëm, siç mund të jetë “Siguria dhe shëndeti në punë”, u referohesh dispozitave të Kodit të Punës. Pra, edhe mund të mos ekzistojë fare ky nen për arsye se hyn drejtpërdrejtë interpretimi sipas nenit 4 të Kodit të Punës. Megjithatë, në mënyrë të shprehur, mund të lihet për të rritur garancitë, por nuk është se sjell ndonjë gjë, është thjesht referim, kjo është ideja.

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me nenin 26 “Ulja e ngarkesës”?

Vasilika Hysi – Në rregull, nuk ka ndryshime.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Neni 27 “Pensioni i parakohshëm”?

Vasilika Hysi – Ky nen ka ndryshime.

Fatmir Xhafaj – Dakord me ndryshimet.

Neni 28 “Pensioni i parakohshëm”?

Vasilika Hysi – Lidhur me nenin 28, nuk ka ndryshime, me përjashtim të një saktësimi që duhet bërë te germa “d”, ku duhet të thuhet: “Nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë”.

Fatmir Xhafaj – Dakord me ndryshimin.

Neni 29 “Thirrja për kandidaturë”?

Vasilika Hysi – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 30 “Aplikimi dhe vlerësimi paraprak i kandidatëve”?

Vasilika Hysi – Jam dakord me këtë nen, zoti kryetar, por për shkak të disa shkurtimeve të neneve që kemi bërë edhe referencat duhet t’i shohim të gjitha në fund.

Fatmir Xhafaj – Neni 31 dakord me ndryshimet?

Vasilika Hysi – Po, dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 32 “Verifikimi i pasurisë dhe figurës”?

Vasilika Hysi – Për nenin 32 bisedova pak edhe me zotin Manja, në germën “b” thuhet: “Kandidati nuk do të pranohet në Shkollën e Magjistraturës kur raportet e Byrosë

Kombëtare të Hetimi ose Shërbimit Inteligent Shtetëror verifikojnë se kandidati ka lidhje me krimin e organizuar.”

Ideja është se prezumohet parimi i prezumimit të pafajësisë ose jo? Ky është një shqetësim që e ngriti zoti Manja, ose këtu do t'i referohemi pastërtisë së figurave në bazë të ligjit “Për organizmin dhe funksionimit të institucioneve” dhe ligjit “Për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar”.

Fatmir Xhafaj – Nuk është e nevojshme, se nuk do të merren raportet e Byrosë Kombëtare të Hetimi ose të Shërbimit Inteligent Shtetëror. Këtu është rregulli i përgjithshëm, pastaj kur të shkojë te këshilli le ta vlerësojë ai se nuk mund të bëjmë përjashtime nga rregulli i përgjithshëm. Këtu ka një rregull të përgjithshëm dhe nuk do të bëjmë shpikje. Byroja Kombëtare e Hetimit është për të luftuar krimin dhe jo për të bërë raporte për magjistratët.

Dakord me ndryshimet e nenit 32.

Paragrafi riformulohet.

Neni 33, “Praktika profesionale rreth kandidatit”.

Vasilika Hysi – Redaktime të vogla.

Fatmir Xhafaj – Neni 34.

Vasilika Hysi – Thjesht është saktësim i terminologjisë, unifikim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Te cili?

Albana Shtylla – Te pensioni i parakohshëm.

Fatmir Xhafaj – Ramë dakord me riformulim.

Albana Shtylla – E lamë “Sipas mendimit të ISSH-së dhe Ministrisë së Financave”.

Fatmir Xhafaj – Po. Ramë dakord me kapitullin, siç është i dakordësuar me ISSH-në, Ministrinë e Financave dhe DAP-in. Jam dakord që të kemi të njëjtin standard.

Për nenin 33, “Praktika profesionale”, jeni dakord?

Vasilika Hysi - Po.

Fatmir Xhafaj – Neni 34, “Lista e renditjes së kandidatëve”.

Vasilika Hysi – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 35, “Emërimi i kandidatit”.

Vasilika Hysi – Dakord me ndryshimet e vogla të terminologjisë.

Fatmir Xhafaj – Po. Redaktoriale janë në të gjithë tekstin dhe nuk po e theksoj për ekonomi kohe.

Petrit Vasili – Mund të bëj një pyetje tek emërimi?

Fatmir Xhafaj – Po.

Petrit Vasili – Çfarë kërkimi ka ky kriter? Është i diplomuar, ka Shkollën e Magjistraturës, formim fillestar me të paktën 70% të pikëve maksimale.

Fatmir Xhafaj – Ata kanë një kriter që, nëse duhet të marrë 100 pikë, quhet kalues nëse ka marrë 70% të pikëve.

Petrit Vasili – Jam dakord me ju, por kjo do të thotë se, nëse merr më pak se 70% të pikëve, quhet ngelës.

Fatmir Xhafaj – Nuk kalon.

Petrit Vasili – Nuk kemi pse të vëmë 70%. Këtu thuhet: “I cili është diplomuar në formim fillestar”. Ne themi: ky njeri duhet të ketë këtë diplomë, duhet të ketë Shkollën e Magjistraturës.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Petrit Vasili – Kur e kanë me 70%, pse e vëmë në ligj?

Vasilika Hysi - Ata renditen në vlerësim.

Petrit Vasili – Në qoftë se nuk është kalues, nuk e ka fituar shkollën.

Fatmir Xhafaj – Këtu është emërimi, është tjetër gjë renditja. Shikojeni si e ka atje, që të mbajmë të njëjtin standard!

Dakord me sugjerimet për nenin 35.

Neni 36, “Emërimi”.

Vasilika Hysi – Me disa ndryshime redaktoriale, i keni përpara.

Fatmir Xhafaj – “Emërimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve”.

Neni 37, “Betimi”.

Vasilika Hysi – Është në rregull.

Fatmir Xhafaj – Neni 38, “Dosjet personale”.

Vasilika Hysi – Ka një ndryshim: “Këshilli do të administrojë dosjet personale dhe regjistrin”, pra nuk mund ta krijojë, “me propozimin e DAP-it”, meqenëse regjistrin e ka DAP-i.

Fatmir Xhafaj – Edhe për këta?

Vasilika Hysi – Po. E kemi edhe te ligji i qeverisjes dhe thamë se këshillat përditësojnë vetëm të dhënat. Kanë akses, por kurrsesi nuk mund të krijojnë regjistra të veçantë.

Petrit Vasili – Më bëri përshtypje një detaj: në asnjë detyrë kushtetuese të këtij vendi, cilado qoftë ajo, as edhe të nivelit profesional, përfshirë edhe ne që kemi zanat tjetër, betohemi për Hipokratën. Dy herë betim nuk ka bërë njeri në botë.

Fatmir Xhafaj – Pse dy herë?

Petrit Vasili – Ka dy betime: magjistrati pas emërimit dhe para fillimit të ushtrimit të funksionit bën betimin si më poshtë. Si betohet dy herë?

Fatmir Xhafaj – Duhet thënë direkt: “para fillimit të ushtrimit”, jo pas emërimit, sepse duket sikur është dy herë, por një herë është.

Petrit Vasili – Dakord, pas emërimit dhe pas fillimit.

Fatmir Xhafaj – Ai nuk mund të fillojë pa u emëruar. Është parazitare. “Para fillimit të ushtrimit të funksionit”. Ai që mund të jetë emëruar, por kur të caktohet ceremonia, të nesërmen ose 1 apo 2 muaj prapa, betohet, por para fillimit të detyrës. Ideja është kur të realizohet ceremonia publike.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Çfarë do të ndryshojë? Betimi bëhet në një ceremoni publike. Hiqe fjalën “i sapoemëruar”, është parazitare.

Do të ndryshojë “para, pas emërimit” dhe “Betimi i magjistratit bëhet me një ceremoni publike të organizuar nga secili këshill përkatës përpara Presidentit të Republikës”. Kjo është për efekt të autoritetit publik, si përfaqësues i unitetit të popullit dhe për vlerën, funksionit më të lartë shtetëror, bëhet para Presidentit, për t’i dhënë më shumë solemnitet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ka rëndësi. Si bëhet? Çfarë do të thuash me këtë?

Vasilika Hysi – Do të bëhet ceremonia për çdo emërim të veçantë?

Fatmir Xhafaj – Thotë: “Betimi i magjistratit bëhet me një ceremoni publike”. Të tjerat i vendosin ata, nuk do të merremi me ceremoninë.

Edhe ministri e bën vetë, vete i gjithë kabineti. Gjithashtu, Magjistrati nuk rri pa bërë betimin. Nuk është pak të shkojë atje të betohet, sepse është President i Republikës.

Dakord me ndryshimet e nenit 37.

Neni 38, “Dosjet personale dhe regjistrimi”, dakord me ndryshimin.

Neni 39, “Caktimi në pozicion të magjistratit të emëruar”.

Vasilika Hysi – Janë bërë disa saktësime bazuar në diskutimet që janë bërë në komision, kryesisht në paragrafin e katërt dhe te pika 8 e këtij neni.

Fatmir Xhafaj – Edhe referencat në ligje, pa dyshim.

Vasilika Hysi – Duhet të shikohen pas shkurtimeve.

Petrit Vasili – Kam sugjerim për të hequr një pikë. Pika 3, që thotë: “Regjistrimi magjistrat është bazë unike” është një përcaktim pa kuptim, pasi neni i parë thotë qartë: “Këshillat administrojnë dosjet personale dhe regjistrin e magjistratit”. Pika 3, “Regjistrimi i

magjistratit është një bazë unike” nuk ka kuptim. Regjistri në vetvete dihet se është bazë unike të dhënash. Ligji nuk thotë se ka regjistra të tjerë, por në pikën e parë thotë se administrojnë dosjet dhe regjistrin e magjistratit. Pika 3 është pa vend.

Fatmir Xhafaj – Ka të drejtë, asgjë nuk thotë. E bën këshilli.

Dakord me ndryshimet që thamë për nenin 39.

Neni 40, “Caktimi i përkohshëm në pozicionet e komanduara të të emëruarve”.

Vasilika Hysi – E kemi përcaktuar terminologjinë sipas kërkesave në komision.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 41, “Të drejtat dhe detyrat e të emëruarit”.

Vasilika Hysi – Ka një saktësim në paragrafin e katërt për mënyrën e përllogaritjes së afateve.

Fatmir Xhafaj – Neni 42, “Transferimi”.

Vasilika Hysi – Ka një saktësim: meqenëse nuk ka qenë e qartë në diskutimin e parë, ekspertët kanë bërë një qartësim se çfarë do të thotë “pozicion i lirë i përhershëm” dhe çfarë do të thotë “transferim, llojet e transferimit” e të tjera.

Fatmir Xhafaj – Dakord, është qartësuar.

Vasilika Hysi – Po, është qartësuar për rastet kur quhet një pozicion i lirë i përhershëm dhe një pozicion i lirë i përkohshëm.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 43, “Procedura e lëvizjes paralele”.

Vasilika Hysi – Këtu ka disa ndërhyrje të bëra duke reflektuar komentet në komision, por njëkohësisht është e nevojshme të vë në dukje se duhen rregulluar të gjitha referencat për spostimet që ka pësuar ligji.

Fatmir Xhafaj – E thamë për referencat e neneve, që të mos e përsërisim vazhdimisht.

Duke qenë se janë spostuar numrat e neneve dhe gerrat, do t’i shikojë edhe një herë pjesa e sekretariatit teknik, që të bëjë referencat e sakta dhe të mos kemi përplasje dispozitash.

Dakord me ndryshimet e bëra në nenin 43.

Neni 44, “Transferimi pa pëlqim”.

Vasilika Hysi – Janë reflektuar të gjitha komentet tona. Kolegët e kanë përpara draftin e rishikuar.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 45, “Magjistratët në sistemin e delegimit”.

Vasilika Hysi – Ka nevojë për një saktësim të paragrafit të tretë dhe zonja Agnes ka një riformulim.

Agnes Bernhard – (*Flet përkthyesja*) Do të sugjeroja të hiqeshin fjalët e fundit për një periudhë që nuk ka...

Ideja është të bëhet dallimi ndërmjet transferimit të përkohshëm dhe skemës së lëvizshmërisë së mobilitetit. Pjesa që propozohet të hiqet e bën konfuze dispozitën, ndaj duhet fshirë.

Fatmir Xhafaj – Dakord me ndryshimet e propozuara për nenin 45.

Neni 46, “Transferim i përkohshëm”.

Vasilika Hysi – Janë reflektuar komentet tona.

Fatmir Xhafaj – I shikoj reflektimet te pikat 2 dhe 5.

Neni 47, “Ngritja në detyrë”.

Vasilika Hysi – Në pikën 9 është shtuar se cilat janë kriteret që duhet të kenë parasysh këshillat dhe është saktësuar. Janë unifikuar termat që janë përdorur në nen.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

(*Diskutime pa mikrofon.*)

Neni 48.

Vasilika Hysi – Në paragrafin 9 të nenit 48 është qartësuar se cilat janë kriteret mbi të cilat vlerësohen kandidatët dhe renditja e tyre. Ka saktësim të terminologjisë.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Petrit Vasili – Te germa “a” e pikës 14 thuhet: “Kriteret e vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale”. Veprimtari profesionale e kuptoj, por etike ...

Fatmir Xhafaj – Kriteret për etikën dhe aftësinë profesionale.

Petrit Vasili – Veprimtari etike nuk ka.

Fatmir Xhafaj – Jo.

Petrit Vasili – Prandaj po them, sepse na stigmatizojnë ndonjëherë për përcaktimet. E vendosim: “kriteret për etikën dhe veprimtarinë profesionale.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Keni edhe disa gjëra të tjera. I gjithë teksti do një pastrim, përveç këtyre që janë më thelbësore, të cilat i përmendi zoti Vasili.

Dakord me ndryshimet e neni 48.

Neni 49, “Emërimi i kandidatëve jogjyqtarë në Gjykatën e Lartë”.

(*Ndërhyrje pa mikrofon.*)

Te neni 48?

Petrit Vasili – Po. Te pika 8, germa “b” thotë: “Në rastin e aftësive të njëjta”. Si do ta interpretojmë në ligj?

Vasilika Hysi - Do të rregullohen nga ana gjuhësore.

Petrit Vasili – Jo, nuk është ana gjuhësore.

Vasilika Hysi – Ideja është se, nëse kandidatët kanë rezultate të njëjta në vlerësimin e aftësive profesionale, kriteri i dytë do të jetë “vitet e eksperiencës profesionale”.

Nëse ju doni të përdoren fjalët e plota, mund të bëhet, por ligji do të zgjatet jashtëzakonisht shumë, sepse vetëm ky nen ka 12 paragrafë dhe...

Fatmir Xhafaj – Ka të drejtë, sepse në rastet e rezultateve të njëjta për vlerësimin e aftësive profesionale do të merren në konsideratë vitet e eksperiencës. Çfarë i ndan aftësitë e njëjta? Rezultatet janë të njëjta, nuk kemi aftësi të njëjta. Këtu thuhet “në rastet e aftësive të njëjta”. Nuk ka dy njerëz me ... Janë rezultatet që dalin nga vlerësimi që u bëhet aftësive. Duhet pastruar i gjithë teksti nga këto.

Dakord me ndryshimet e nenit 48.

Neni 49, “Emërimi i kandidatëve jogjyqtarë në Gjykatën e Lartë”. Ramë dakord me ndryshimet.

Petrit Vasili – Germa “b” te pika 12, thotë: “Kriteret për procedurën e vlerësimit të aftësive profesionale, por edhe aftësive gjuhësore”. Çdo të thotë “aftësive gjuhësore”?

Vasilika Hysi – Të shkruajnë shqip, sepse shkruajnë me gabime.

Petrit Vasili – Nuk e themi dot këtë gjë.

Fatmir Xhafaj – Bëjeni “shkrimi ligjor”, sepse ai mund të mos dijë të flasë fare, por shkruan bukur.

Petrit Vasili – Po, ti atë i vlerëson.

Fatmir Xhafaj – Ai flet me vendime, nuk është deputet që të ketë aftësi për t’u shprehur.

Vasilika Hysi – E kemi për ata që nuk dinë të shkruajnë fjalët, nuk dinë foljet.

Fatmir Xhafaj – Po, ndaj po themi ta vendosim “shkrim ligjor”. Vini një rregull për shkrim ligjor.

Vasilika Hysi – Nuk është thjesht aftësia e shkrimit ligjor, por edhe e gjuhës shqipe.

Fatmir Xhafaj – Ai është profesor, është me gradë shkencore, si mund të mos dijë gjuhë shqipe? Vendosni “shkrim ligjor”. Ai mund të jetë pedagog, por nuk di të shkruajë ...

(Ndërrhyrje pa mikrofoni.)

Petrit Vasili –*(Nuk dëgjohet)*... Një seri kriteresh, të cilat, kur vijnë te pika 12, kanë shteruar atë që është kualiteti i këtij njeriu. Në qoftë se ne vijmë te pika e parë, që ky ka

problematika të mëdha në mënyrën e artikulimit, në të shkruar e të tjera, nuk bën punë as te komisioni ynë, jo atje.

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, pastrojini nga këto.

Agnes Bernhard – (*Flet për kthyesja*) Propozimi im është ta fshijmë, sepse përfshihet tek aftësitë profesionale.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 50, “Emërimi i prokurorit të Përgjithshëm”.

Vasilika Hysi – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 51, “Zgjedhja e kryetarit të Gjykatës së Lartë”.

Vasilika Hysi – Janë bërë disa saktësime të terminologjisë.

Fatmir Xhafaj – Neni 52, “Emërimi i kryetarëve ...”.

Vasilika Hysi – Është standardizuar terminologjia dhe në paragrafin 4 është plotësuar fjalia, që të mos ngrihet shqetësimi që ngriti zoti Vasili për fjalitë e lëna në mes.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Vasilika Hysi – Ndërkohë, ka plotësime te paragrafët 7 dhe 10 për të treguar se mbi bazën e cilave rezultate bëhen kriteret e vlerësimit: në rastet kur kandidatët kanë të njëjtin nivel të vlerësimit, kur kanë një ...

Fatmir Xhafaj – Ky e ka shprehur shumë mirë: “Këshillat miratojnë rregulla më të detajuara, të cilat përcaktojnë: a-Kriteret për vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale ndërmjet magistratëve me pikë të barabarta vlerësimi. Kjo është e shkruar.

Vasilika Hysi – Bazuar në shqetësimin e zotit Vasili, te paragrafi 12 do të heqim fjalët “veprimtari etike” dhe do të themi “kriteret për vlerësimin e etikës, veprimtarisë profesionale ndërmjet magistratëve me pikë të barabarta vlerësimi”.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 53, “Parimet e komandimit”.

Vasilika Hysi – Këtu ka një diskutim, zoti kryetar, të cilin e kemi bërë mbrëmë edhe me zonjën Agnes. Në paragrafin e dytë, pas riformulimit që kanë bërë ekspertët, bazuar në diskutimet tona, kanë zgjeruar rrethin e institucioneve, ku një magistrat mund të komandohet dhe të ruajë statusin e magistratit. Jam dakord që një magistrat mund të shkojë në Gjykatën e Lartë, në Gjykatë Kushtetuese, në Prokurorinë e Përgjithshme, Inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë apo në këshilla, por nuk bën shumë sens që një magistrat të shkojë në një organizatë ndërkombëtare, të punojë në një mision të huaj dhe eksperiencë e atjeshme të quhet si eksperiencë gjyqtari. E kanë zgjeruar dhe kanë thënë: “misione të

asistencës ose organizata ndërkombëtare që ushtrojnë veprimtari në sistemin e drejtësisë” ose çdo institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë.

Fatmir Xhafaj – Ku është ideja këtu?

Vasilika Hysi – Këtë do të doja të ...

Agnes Bernhard – (*Flet përthyesja*) Kjo lihet e hapur për gjyqtarët, që të shkojnë në këto pozicione nëse është për interes të shtetit.

Për shembull, në qoftë se një mision asiston Ministrinë e Drejtësisë në një hartim ligjor tepër kompleks, do të ishte fitimprurëse që një gjyqtar t’i bashkohej këtij misioni.

Megjithatë, unë e kuptoj shqetësimin e zonjës Hysi dhe mund të bëj një kufizim në emërimin e gjyqtarit pranë misioneve të neni 54, “Për procedurën e delegimit” dhe të kufizohet të rastet që nuk ka vende vakante për t’u plotësuar nga këta gjyqtarë ose kur ekziston një interes publik. Kjo duhet vendosur nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Fatmir Xhafaj – Dakord, sepse që të shkojë te Ministria e Drejtësisë...

Këtu duhet vendosur edhe Kuvendi. Mund të ...

Agnes Bernhard – (*Flet përthyesja*) Në përkufizimin e këtyre kemi përfshirë dhe institucione brenda sistemit të drejtësisë.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Të qëndrojmë te pjesa jashtë sistemit. Ministria e Drejtësisë i ka të nevojshëm, të themi të drejtën.

Dakord me ndryshimet.

Neni 54, “Procedurat e komandimit”.

Vasilika Hysi – Kjo dispozitë ka pësuar ndryshime, ka ardhur në një formë më të plotë dhe ka thjesht probleme redaktimi.

Fatmir Xhafaj – Te pika 4 ka probleme riformulimi.

Vasilika Hysi – Po.

Fatmir Xhafaj – Dakord me ndryshimet e nenit 54.

Neni 55.

Petrit Vasili – Te pika 5, “Inspektori i Lartë i Drejtësisë”, vazhdon: “Këshilli konfirmon inspektorin nëse ai/ajo është vlerësuar të paktën shumë mirë”. Nuk mund të thuhet “të paktën shumë mirë”. Shumë mirë është një vlerësim maksimal. Fjalët “e pakta” duhet të jenë më poshtë.

Mund të jetë shumë mirë, mirë, i kalueshëm, i pakalueshëm.

Fatmir Xhafaj – Ka vlerësim tjetër?

Agnes Bernhard – (*Flet përkthyesja*) Është një shkallë tjetër vlerësimi, “shkëlqyer”, kështu që donim të përfshinim “shumë mirë” dhe “shkëlqyer”. Ndaj është “të paktën”, sepse mund të jetë edhe “shkëlqyer”.

Petrit Vasili – Sistemi bazik i vlerësimit në të gjithë botën, edhe në Shqipëri, ka tri nivele, që janë: i pakalueshëm, niveli minimal, niveli mesatar dhe niveli maksimal.

Fatmir Xhafaj – Këta kanë...

Petrit Vasili – Niveli shkëlqyeshëm. Ekselenca është ekstra gjithë kohën. Kështu ka qenë kudo. Nëse doni, mund të shikoni shembujt e shteteve si Italia fqinje, që ka trenta, por ka edhe trenta elode. Të thuash “të paktën shumë mirë”, “të paktën mirë”...

Fatmir Xhafaj – Mund ta heqim edhe fjalën “shkëlqyeshëm”, sepse imagjinoni t’i thuhet një qytetari “ky gjyqtar është vlerësuar shkëlqyeshëm”... E kupton?

Zonja Agnes, vlerësohen shkëlqyeshëm në Austri? Në Gjermani vlerësohen.

Dakord me ndryshimet e sugjeruara në nenin 55.

Neni 56.

Petrit Vasili – Te pika 2, “Këshilli konfirmon ndihmësmagjistratin nëse është vlerësuar të paktën shumë mirë”, është sërish e njëjta gjë.

Fatmir Xhafaj – Dakord me ndryshimin e pikës 2 të nenit 56.

Neni 57, “Përfundimi i kohëzgjatjes së komandimit”.

Vasilika Hysi – Në rregull.

Fatmir Xhafaj – Neni 58, “Rregulla të detajuara për komandimin”.

Vasilika Hysi – Në rregull.

Fatmir Xhafaj – Hiqini fjalët “veprimtari etikë” e të tjera.

Vasilika Hysi – Në fakt, janë shtuar, sepse “vlerësimi etik” nuk ka qenë.

Fatmir Xhafaj – Jo, ka qenë në “vlerësimin etik”. Fjala “veprimtari” është shtuar më pas për ta lidhur me profesionalen, por është bërë gabim.

Dakord me ndryshimet e nenit 58.

Neni 59, “Caktimi i përkohshëm”.

Vasilika Hysi – Në paragrafin e dytë janë qartësuar cilat janë pozicionet e përkohshme që mund të krijohen. Ka edhe një shtesë në paragrafin 8 sesi mund të plotësohet një pozicion, që është përkohësisht i lirë përmes caktimit të përkohshëm të magjistratit. “Kur magjistrati caktohet në një pozicion që është përkohësisht i lirë ka të drejtë të kthehet në pozicionin e tij të mëparshëm ose të caktohet në atë pozicion në mënyrë të përhershme. Nëse magjistrati është caktuar përkohësisht, ka të drejtë të kthehet në atë pozicion deri në përfundimin e afatit të caktuar”.

Kemi pasur një diskutim me ekspertët për të mos krijuar keqinterpretime në praktikë. Pikërisht riformulimi që i është bërë këtij neni plotëson edhe shqetësimin e zotit Vasili për t'i thënë gjërat jo shkurt, por saktë dhe qartë.

Petrit Vasili – Cila është baza ku jemi referuar për përcaktimin?

Është vetëm një sqarim që kam për nenin 57, jam dakord me të tjerat, përcaktimi që në pikën 3 të nenin 57 është se mund të merret në konsideratë përfundimi i kohëzgjatjes së mandatit kur ka kryer 4/5-at.

Pyetja është: ky ndryshon 4/5-at nga 3/4-at që është mbi 75% e kohës së mandatit?

Fatmir Xhafaj – Sa e ka mandatin?

Vasilika Hysi – 5.

Petrit Vasili – Maksimumi është 5, por mund të jenë edhe periudha më të shkurtra. Tani, do të mbetemi peng i ndonjë kriteri matematikor, apo kemi edhe ndonjë logjikë më të fortë? Thjesht për të qenë të qetë me njëri-tjetrin, sepse një nga pikat ku mund të përplaslet shpesh herë përfundimi është afati. Mund edhe të lëvizë. Ky minimum, nëse nuk i ka për 80% të kohës, mund të jetë nevoja për të lëvizur atje, do të mbetet peng i kësaj matematike. Mos duhet një fleksibilitet dhe ta ulim këtë gjë, sepse kemi nevojë për ta përfunduar, sepse do të ngelemi në ngërç.

Vasilika Hysi – Kjo është për promovimin, ngritja në detyrë.

Fatmir Xhafaj – Pse duhet ta bëjmë ne këtë gjë?

Petrit Vasili – Të mbarojë periudhën e komandimit dhe mbyllet.

Fatmir Xhafaj - Pse duhet ta ngremë në detyrë, apo që të vijë ai këtu dhe më pas tak, ta ngrenë në detyrë, siç bëjnë zakonisht?

Petrit Vasili – Ne kemi lënë edhe diçka tjetër, kemi vënë një tavan, që komandim më shumë se 5 vjet nuk mund të ketë.

Vasilika Hysi – Është dy herë nga 5 vjet.

Petrit Vasili – Në një komandim, është të kalojë 5 vjet

Fatmir Xhafaj – Të paktën të ketë mbaruar 5 vjet.

Petrit Vasili – Të vendosim standardin që ky komandim konsumohet. Ne e kemi vendosur deri në 5 vjet, por ta mendojmë, se komandimi mund të jetë, edhe 3 vjet, mund të jetë edhe 2 vjet apo edhe 1 vit e gjysmë, sa të jetë e nevojshme.

Fatmir Xhafaj – Mund të ndodhë që e bën 3 vjet, dhe këtu ke të drejtë, e sjell këtu dhe që më pas ta ngrenë në detyrë. Bie këshilli dakord dhe thotë se po të marr 3 vjet këtu, që të ngrihesh në detyrë. Kështu që bëhet 5 vjet një herë dhe më pas...

Petrit Vasili – E saktë.

Fatmir Xhafaj – Nuk mund të bëjmë gjëra që mund të jenë abuzive, të cilat mund të krijojnë lidhje të shkurtra brenda në sistemit.

Agnes Bernhard – (*Flet përkthyesja*) Ideja është që të shmanget abuzimi me dispozitat e ligjit dhe të bëhet ky delegimi për institucionet e tjera, që të shërbejnë në institucionet e tjera, më pas të çojnë në ngritjen në detyrë.

Fatmir Xhafaj – Qartë, por nuk kemi pse ta vendosim 4/5-at të mbarojë periudhën e plotë të delegimit dhe më pas ta ngrenë në detyrë. Në rregull.

Neni 60 “E drejta e kthimit”.

Vasilika Hysi – Në lidhje me nenin 60 ka një saktësim të paragrafit të parë: “Kur personi nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin, sipas parashikimit të këtij ligji, pas mbarimit të periudhës së përkohshme, ai ka të drejtë të kthehet në pozicionin e mëparshëm”. Pastaj pjesa tjetër janë ndryshime redaktoriale.

Fatmir Xhafaj – Neni 61 “Kufizimi i mandatit me ligj”.

Vasilika Hysi – Nuk ka probleme, i referohet Kushtetutës.

Zoti kryetar, ky nen zgjidh shqetësimin që ne kemi për funksionarët e lartë, kryetarin e gjykatës, prokurorin e Përgjithshëm, inspektorin, të cilët ngelen pa punë.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Ai është prokuror i Përgjithshëm, nuk mund të dalë në rrugë më pas. Mbaron mandatin, çfarë të bëjë ai? Siç ka ndodhur me kryetaren e Gjykatës së Lartë, që tani është pa punë.

Neni 62.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, lidhur me nenin 62, unë dua të saktësoj pak termin “edhe në raste të tjera”. Kjo duhet përcaktuar kur një gjë e tillë e parashikon ligji. Pra, emërimi në nivel Apeli, patjetër do të jetë për gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, prokurorin e Përgjithshëm ose prokurorët e Zyrës së Prokurorisë së Posaçme, por në qoftë se ligje të tjera parashikojnë, që titullari duhet të shkojë....

Agnes Bernhard – (*Flet përkthyesja*) Në cilin paragraf është?

Vasilika Hysi – Te paragrafi i parë i nenit 62, pra është përdorur termi “ose në raste të tjera kur ligji parashikon”, “ose në raste të tjera të parashikuara me ligj”. Kemi rënë dakord me ekspertët për këtë saktësim.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Vasilika Hysi – Me këtë saktësim kemi rënë dakord me ekspertët.

Fatmir Xhafaj - Neni 63.

Vasilika Hysi - Neni 63 është në rregull, janë reflektuar diskutimet në komision dhe janë siç i keni përpara.

Fatmir Xhafaj – Duhet ta saktësojmë këtë: ai që është prokuror, shkon në prokurori, ai që është gjyqtar, shkon në Gjykatën e Apelit, sepse mos ndoshta e kuptojnë gabim këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Besoj se është e qartë për ju, nuk do të ketë keqkuptime që dikush të pretendojë dhe të thotë: për shembull, unë jam kryetar i Gjykatës së Lartë, dua të shkoj prokuror ose anasjelltas. Ju lutem, bëni një shënim dhe saktësoheni këtë! Për shembull, ai mbaron mandatin si prokuror në Zyrën e Prokurorisë së Posaçme dhe thotë se që do të shkoj në gjykatë tani. Prandaj ndaheni këtë gjë, që të jetë e qartë të mos ketë keqkuptime.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kriterin e plotëson ai, shkollën të gjitha. Ju lutem, saktësoheni!

Në rregull, neni 62 me ndryshimet.

Neni 63 “Mbarimi i mandatit të kryetarit”.

Vasilika Hysi – Ky nen është në rregull, nuk ka probleme.

Fatmir Xhafaj – Në rregull me ndryshimet që janë bërë në pikën 1.

Mandati i cilit kryetar është ky?

Vasilika Hysi - Përkufizimi i kryetarit është dhënë te neni i përkufizimeve.

Fatmir Xhafaj - Kreu VII “Mbarimi i statusit të magjistratit”.

Neni 64 “Kohëzgjatja në detyrë e magjistratit”.

Vasilika Hysi – Është në përputhje me kërkesat e Kushtetutës, se kur mbaron mandati i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, prokurorit të Përgjithshëm dhe magjistratit në përgjithësi, pra rregullohen të gjitha në një dispozitë.

Fatmir Xhafaj - Në rregull.

Neni 65 “Dorëheqja”.

Vasilika Hysi – Te “Dorëheqja” sugjeroj të bëjmë një redaktim të paragrafit 2, sepse nuk del e qartë, ku lexohet: “Dorëheqja duhet të jepet me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar”. Pra, nuk ka nevojë të jetë e arsyetuar.

Fatmir Xhafaj – Në rregull neni 65, me ndryshimet e paraqitura. Ato që janë ndryshime dhe që i keni të gjithë përpara për efekt kohe të mos i lexojmë. Të lexojmë vetëm ato që janë thelbësore.

Vasilika Hysi - Në rregull, këto janë ndryshime që nuk janë.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, vetëm ato që janë ndryshime thelbësore të themi, që kanë nevojë për debat. Në qoftë se nuk kanë nevojë janë redaktoriale apo të teknikës legjislativë, sepse i kemi përpara ato që janë propozuar nga ekspertët.

Vasilika Hysi – Në rregull.

Fatmir Xhafaj – Neni 65 “Pazgjidhshmëria dhe papajtueshmëria”.

Vasilika Hysi – Është në rregull, vetëm referencat në fund.

Fatmir Xhafaj - Në rregull, me ndryshimet që kemi në tekst, me reflektimet që janë bërë.

Neni 66 “Pamundësia fizike dhe mendore e një magjistrati”.

Vasilika Hysi – Është në rregull. Madje, zoti kryetar, do të thosha se te ligji “Për pushtetin gjyqësor” ju kishit një shqetësim dje për ekspertët që mund të merrte këshilli. Ne mund të marrim riformulimin e pikës 2 këtu, që është e saktë, për ta unifikuar edhe me ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, si?

Gent Ibrahimi – Vetëm një ndryshim, ajo që ju referuat, neni 65, ka një gabim, është neni 66, dhe ajo që referuat neni 66, është neni 67.

Fatmir Xhafaj – Po, keni të drejtë është shkruar gabim, neni 65 ishte “Dorëheqja”, neni 66 është “Pazgjidhshmëria dhe papajtueshmëria”, dhe neni 67 është “Pamundësia fizike dhe mendore e magjistratit”.

Gent Ibrahimi – Më pas vazhdon siç duhet.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, me ndryshimet e paraqitura.

Më fal, Genti këto si lexohen: titull apo kapituj? Mbi kreu është titulli, sepse titulli...?

Gent Ibrahimi – Te qeverisja kemi bërë “Pjesa” dhe “Kreu”.

Fatmir Xhafaj – Urdhëro!

Gent Ibrahimi - Te projektligji i qeverisjes kemi thënë pjesa dhe kreu.

Fatmir Xhafaj – Ta bëjmë edhe këtu një standard, Etilda, pra brenda ligjeve gjyqësore të ketë një standard, jo në një vend të quhet “Titull” dhe në një vend të quhet “Pjesa”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull, por ne të mbajmë një standard, sepse i kemi ligje binjake, në të njëjtën kohë po dalin. Po të ishin në kohë të ndryshme në rregull, por në datën 29 do të kalojnë në

parlament. Jo njëri me “Titull” dhe tjetri me “Pjesë”, sepse janë binjakë, dhe nuk mund të jenë me emra të ndryshëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sigurisht, ashtu është. Në rregull, pastaj vendosini si të doni, por vetëm gjuha të jetë e njëjtë.

Neni 68 “Qëllimi i vlerësimit të veprimtarisë”.

Vasilika Hysi – Në rregull.

Fatmir Xhafaj – Neni 69 “Parimi”.

Vasilika Hysi – Në rregull.

Fatmir Xhafaj – Neni 70 “Subjekti i vlerësimit”.

Vasilika Hysi – Në rregull.

Fatmir Xhafaj – Neni 71.

Vasilika Hysi – Te neni 71 kishit një detyrë shtëpie për termin, “aftësitë prokuroriale”. Kemi gjetur një term tjetër.

Fatmir Xhafaj – Bëjeni “Aftësitë si gjyqtar dhe si prokuror”, pse duhet ta bëni “prokuroriale”?

Pandeli Majko – Ky term nuk ekziston.

Fatmir Xhafaj– Pra, “Aftësitë si gjyqtar dhe si prokuror”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull, me ndryshimin.

Vasilika Hysi – “Aftësitë si gjyqtar” dhe “Aftësitë gjyqësore”, “gjykimit” janë të tjera.

Pandeli Majko – “Aftësi gjyqtareske” kemi ne?

Petrit Vasili – “Si gjyqtar”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Ne vlerësojmë aftësitë si gjyqtar dhe aftësitë si prokuror. Kaq!

Urdhëroni!

Agnes Benrhard – *(Flet përkthyesja)* Siç e shikojmë ne, gjyqtari ka aftësi të ndryshme, mes të cilave është menaxhimi, komunikimi me palët dhe shkrimi i arsytimeve ligjore. Aftësia gjyqësore që kemi shkruar këtu, ka të bëjë me këtë të fundit. Kështu që nuk besoj se është e duhur të thuhet: “Aftësia si gjyqtar”, sepse në këtë rast i referohemi kësaj të fundit “Shkrimi të arsytimeve ligjore”.

Fatmir Xhafaj - Në rregull, por ai gjyqtar është. Shkrimi nuk është aftësi gjyqësore, aftësi si gjyqtar është. Me logjikën që ju thoni, bie si sekretar gjyqësor, sepse edhe

prokurorale, nuk gjejmë dot term. Në rregull, jeni të lirë deri pasdite që t'i gjeni një term, pastaj në qoftë se nuk gjeni, do të ngelet “Aftësia si gjyqtar” .

Në rregull.

Faleminderit!

Neni 73 “Aftësia si prokuror”, sipas meje në rregull, ju në qoftë se gjenin një term më të mirë, vendoseni.

Neni 74 “Aftësitë organizative”.

Vasilika Hysi – Ky nen është në rregull.

Fatmir Xhafaj - Neni 75 “Kriteret e etikës”.

Vasilika Hysi – Neni 75 “Kriteret e etikës dhe të angazhimit”, ky nen është në rregull.

Fatmir Xhafaj - ... “ndaj vlerave të profesionit, ndaj vlerave profesionale.”

Vasilika Hysi – Këto do t'i rregullojmë, ashtu sikurse thatë ju, për të gjitha.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Në rregull, neni 75 me ndryshimin.

Neni 76.

Vasilika Hysi - Ky nen është në rregull.

Fatmir Xhafaj – Neni 77 “Burimet e vlerësimit”.

Vasilika Hysi - Ky nen është në rregull, duke rregulluar termat që nxorët në pah. Edhe te neni 78 do të rregullojmë terminologji në “veprimtari etike”, që zoti Vasili e kishte merak në gjithë tekstin.

Fatmir Xhafaj – Neni 79 “Kriteret për vlerësimin e veprimtarisë së kryetarit”.

Vasilika Hysi – Ky nen është i saktë, nuk ka probleme.

Fatmir Xhafaj – Neni 80 “Aftësitë drejtuese dhe organizative”.

Vasilika Hysi – Edhe ky nen është i saktë, vetëm duke rregulluar terminologjinë, që thatë ju “prokuroriale”.

Fatmir Xhafaj – Neni 81 “Aftësitë e komunikimit”.

Vasilika Hysi – Ky nen është në rregull, nuk ka probleme.

Fatmir Xhafaj – Neni 82 “Burimet e vlerësimit për veprimtarinë e kryetarit”.

Vasilika Hysi – Ky nen është në rregull.

Pandeli Majko – Te neni 81 “Aftësitë e komunikimit termi “linjë komunikimi” duhet shqipëruar, sepse duket sikur duhet të flasë qartë në telefon. Në shqip “linjë komunikimi”...

Fatmir Xhafaj – “Për të pasur komunikim të qartë, në kohë dhe transparencë”.

Pandeli Majko – “Aftësi komunikuese të qarta në kohë dhe transparente” .

Fatmir Xhafaj – Për të pasur komunikim të qartë.

Pandeli Majko - Shqipja është gjuhë e vështirë, sepse u bie shkurt ca gjërave.

Fatmir Xhafaj - Neni 82 dakord me ndërhyrjet.

Neni 83 “Nivelet e vlerësimit”.

Vasilika Hysi - Në rregull.

Fatmir Xhafaj - Neni 84 “Periudha e vlerësimit”.

Vasilika Hysi - Në shqip nuk themi: “në rastin e kandidimit”, por “në rastin e paraqitjes së kërkesës për transferim”, sepse, me zonzjën Agnesse folëm, është përdorur termi “aplikim”, ndërsa këtu thuhet “kandidim” .

Fatmir Xhafaj – Te “Periudha e vlerësimit”.

Vasilika Hysi – Po do të rregullojmë terminologjinë te paragrafi 4.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, me ndryshimin.

Neni 85 “Programi dhe njoftimi i vlerësimit”.

Vasilika Hysi – Në rregull.

Zoti kryetar, vetëm se këtu është përdorur termi “performancë etike”, nga “veprimtari etike”. Unë them që t’i unifikojmë në fund nga ana gjuhësore dhe të themi një term.

Fatmir Xhafaj - Në rregull.

Neni 86 “Vetëvlerësimi”.

Vasilika Hysi - Është në rregull, është sipas projektit që keni përpara.

Fatmir Xhafaj - Neni 86 në rregull.

Neni 87 “Mendimi i kryetarit”.

Vasilika Hysi - Nuk ka ndryshime.

Fatmir Xhafaj - Neni 88 “Dërgimi i akteve të vlerësimit nga kryetari”.

Vasilika Hysi - Është në rregull, nuk ka ndryshime.

Fatmir Xhafaj - Neni 89 “Përgatitja e dokumentacionit”.

Vasilika Hysi - Në rregull.

Fatmir Xhafaj - Neni 90.

Vasilika Hysi - Në rregull.

Fatmir Xhafaj – Neni 91 ”Zgjidhja e çështjeve për vlerësim”.

Vasilika Hysi - Në rregull.

Fatmir Xhafaj – Neni 92.

Vasilika Hysi - Në rregull

Fatmir Xhafaj – Neni 93 “Projektraporti i vlerësimit.

Vasilika Hysi - Në rregull.

Fatmir Xhafaj – Neni 94 “E drejta magjistratit për të bërë projektin e raportit të vlerësimit”

Vasilika Hysi - Në rregull. Nuk po flasim për redaktimet gjuhësore.

Fatmir Xhafaj – Neni 95 “Vendimi për vlerësimin”.

Vasilika Hysi - Në rregull.

Fatmir Xhafaj – Neni 96 “Procedura e vlerësimit për kryetarin”.

Vasilika Hysi - Në rregull, vetëm me kujdes referencat, pas ndryshimit të numërtimit.

Fatmir Xhafaj – Neni 97 “Raportimi dhe transparenca”.

Vasilika Hysi - Në rregull.

Fatmir Xhafaj - Neni 98 “Raporti i vlerësimit”.

Vasilika Hysi - Në rregull.

Fatmir Xhafaj - Neni 99 “Raporti periodik për sistemin e vlerësimit” .

Vasilika Hysi - Në rregull.

Fatmir Xhafaj - Neni 100 “Parimet e procedimit disiplinor”.

Vasilika Hysi - Këtu do të kemi pak kujdes, sepse kanë bërë disa reflektime ekspertët nga diskutimi që i kemi bërë në komision. Dy terma që mund të krijojnë keqkuptime në shqip, sepse me kolegët ishte ndryshe, është germa “b”, ku thuhet: “Parimi i ligjshmërinë, në kuptimin, që organi kompetent ka detyrimin të hetojë nëse ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur një shkelje disiplinore”. Kjo vjen nga standardi i konventës, por në shqip...

Fatmir Xhafaj – Çfarë pike është kjo?

Vasilika Hysi – Germa “b”, paragrafi 1

Fatmir Xhafaj – “Parimin e mosdënimit pa ligj”, më fal, për kë e kishe fjalën?

Vasilika Hysi – Jo te germa “b” thuhet: “Parimi i ligjshmërisë, në kuptimin, që organi kompetent ka detyrimin të hetojë nëse ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur një shkelje disiplinore”. Kjo është riformuluar, po ta shikoni.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Urdhëroni!

Petrit Vasili – Jam dakord me të gjitha nenet deri këtu, kam vetëm një sugjerim për sa u takon neneve 85 dhe 86. Këto nene do të insistoja të ishin një nen i vetëm dhe neni 86 të vazhdonte, pika 3: “Në funksion të vlerësimit magjistrati dorëzon...” dhe aty me radhë do të

thuhen të gjitha: analizën e të dhënave etj, dhe të heqim përzierjen e dy koncepteve, “të vlerësimit” dhe “të vetëvlerësimit”, sepse nuk ka asnjë raport ndërmjet vlerësimit dhe vetëvlerësimit. Vetëvlerësimi nuk ka asnjë rol, është thjesht dhe vetëm paraqitje e informacionit Komisionit të Vlerësimit, i cili do të bëjë vlerësimin.

Unë mendoj se duhet një nen 85. E gjithë procedura që përshkruhet në nenin 86, si e ashtuquajtur “vetëvlerësim”, nuk ka asnjë sens juridik.

Pas pikës 2 duhet të vazhdojë pika 3: “Magjistrati që merr njoftimin për vlerësimin e tij brenda tre javëve paraqet...”, aty shkruhen të me radhë të gjitha pikat që janë paraqitur këtu dhe kështu evitojmë historinë e vetëvlerësimit. Në fund të gjësë do të na pyesin: çfarë raporti ka midis vlerësimit dhe vetëvlerësimit? Procesi është shumë i thjeshtë. Këta duan të bëjnë një vlerësim dhe që ta bëjnë vlerësimin objektiv i duhen paraqitur 1, 2, 3, 4 materiale.

Fatmir Xhafaj – Ideja është për të harmonizuar më mirë nenin 85 dhe 86 dhe për ta ndarë atë që është procedurë nga ajo që është vlerësim, pra nga ajo që është proces.

Dakord.

Shumë faleminderit, zoti Vasili!

Neni 100 “Parimet e procedimit disiplinor”.

Dakord me ato që u sugjeruan.

Neni 101 “Shkeljet disiplinore dhe çështje të veprimtarisë”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vasilika Hysi – Te neni 101 janë saktësuar shkeljet disiplinore. Në fakt, ka pasur një diskutim shumë të gjatë midis nesh në lidhje me detajimin e tyre. Të gjithë magjistratët kanë kërkuar që gjërat duhet të jenë të sakta në ligj dhe të mos lihet shteg për keqinterpretime. Kemi pasur një diskutim me zonjën Agnesse lidhur me pakujdesinë, shpeshhtësinë e kryerjes së gabimit e të tjerë dhe është lënë që të jetë e detajuar gjithçka.

Diskutimi i vetëm, zoti kryetar, është se çfarë dot ë quhet “pakujdesi e lehtë” dhe “pakujdesi e rëndë”, pasi mund të jetë pak subjektive. Për shembull, në paragrafin e parë thuhet: “Magjistrati kryen shkelje disiplinore në këto raste...” dhe në germën “b” thuhet: “Kur haptazi nuk i referohet ligjit ose fakteve për shkak të pakujdesisë së rëndë ose dashjes, ose kur ka paaftësi të dukshme profesionale”.

Kemi pasur një diskutim dhe unë dua që të ndalemi pak te këto terma, sepse mund të bëhen shkak të vlerësimit subjektiv. Ky është kapitulli më i rëndësishëm në lidhje me shkeljet disiplinore. Nuk është në praktikën tonë të mëparshme kjo lloj terminologjie, sepse nuk ka ekzistuar, çdo abuzim ia kemi pas lënë KLD-së dhe KLP-së, të vendosnin ata vetë, siç donin.

Por, duke futur këto lloj termash, do të ishte mirë të ishim të qartë. Ndoshta duke pasur edhe një sqarim nga zonja Agnese, që të jetë një dokument, i cili do të bëjë dallimin midis “pakujdesisë së rëndë” dhe “pakujdesisë me dashje. Pra, të paktën të jetë si një material, tek i cili mund të referohet në të ardhmen kushdo që mund të ankohet për një zbatim subjektiv.

Fatmir Xhafaj – A t’ia lëmë Këshillit, që ta bëjë ai përcaktimin?

Gent Ibrahimi – Këshilli do ta bënte, gjithsesi, edhe kështu siç është.

Fatmir Xhafaj – Domethënë, t’ia lëmë atij kompetencë, që të përcaktojë se çfarë do të konsiderojë shkelje të rëndë, si dhe llojin e shkeljes.

Agnes Bernhard – (*Flet për kthyesja*) Kjo gjë do të vendoset nga praktika gjyqësore dhe e gjykatës.

Fatmir Xhafaj – Specifikojeni që të jetë më e qartë.

Petrit Vasili - Ne tani kemi ndërtuar një arkitekturë të qeverisjes së gjyqësorit, apo jo? Kjo arkitekturë nënkupton që ne i japim disa attribute kësaj qeverisjeje të re që të përcaktojë edhe standardet. Ne kemi ndërtuar një qeverisje gjyqësore që jo t’i shkruajmë çdo element në ligj, por t’i japim normat orientuese në ligj dhe më pas detajimet profesionale t’i bëjnë ata. Nuk mund të jetë shterues ligji për këtë gjë, sepse po të jetë shterues, atëherë nuk ka gjë në botë që të shpjegojë që haptazi nuk i referohesh ligjit, por edhe fakteve nëse e bën nga pakujdesia apo me dashje. Të mos i referohesh ligjit dhe fakteve haptas, do të thotë që e bën me dashje, në gjykimin tim. Unë nuk kam gjykim profesional. Një profesionist i mirë përcakton disa kritere më të imëta dhe thotë se kjo ka ardhur nga pakujdesia. Pra, ne t’ia lëmë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe nuk e ngarkojmë ligjin, sepse duke e vënë në ligj ai bëhet më i keqinterpretueshëm dhe i papenalizueshëm në të gjitha rastet. Po kështu edhe në nivelet e pakujdesisë së rëndë dhe pakujdesisë së lehtë, shpesh të kryerjes së gabimit. Shkalla e pakujdesisë ka një seri konceptesh, ka shumë evazivitete, të cilat është më mirë të normojmë elementet kryesore, që duhet të vlerësohen dhe t’i zbërthejnë ata.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, vendoseni këtë si klauzolë te pika 3, ose bëni një pika 4, sepse ajo që tha zonja Hysi dhe zoti Vasili është e njëjtë me atë që tha zonja Agnese, praktika mund të jetë e larmishme, ata rast pas rasti e unifikojnë për të pasur standarde vlerësimi.

Dakord.

Neni 102 “Shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksioneve”.

Dakord me ndryshimet e bëra në tekst.

Neni 103 “Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit”.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, unë kam një shqetësim të germa “dh”, ku thuhet: “Shkelje të kryera të paktën me pakujdesi”.

Pandeli Majko – Nuk ekziston ky definicion.

Vasilika Hysi – Pakujdesi është edhe neglizhenca, ajo është formë e pakujdesisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Te neni 103, germa “dh”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – “Shkelje të detyrimeve të ligjit në lidhje me deklarimin e pasurive”. Kaq është e saktë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Saktësojeni.

Neni 104 “Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale”.

Dakord.

Neni 105 “Masat disiplinore”.

Vasilika Hysi – Këtu është shtuar diçka për Gjykatën e Posaçme, për gjykimin e veprave penale...

Petrit Vasili – Te neni 104 nuk mund të themi “faktet e kryera nga magjistrati”. Çfarë do të thotë “faktet e kryera”?

Pandeli Majko – Është e paimagjinueshme.

Vasilika Hysi – “Faktet për të cilat magjistrati është deklaruar fajtor”.

Fatmir Xhafaj – Te germa “ç”.

Petrit Vasili – Çfarë do të thotë “faktet e kryera nga magjistrati”, te germa “ç”?

Vasilika Hysi – Veprimet ose mosveprimet e kryera...

Petrit Vasili – Dakord, por duhen reflektuar, sepse nuk thuhet “faktet e kryera nga magjistratët”.

(Diskutime pa mikrofon.)

Agnes Bernhard – *(Flet përkthyesja)* Një vendim disiplinor merret pasi kryhet edhe një procedim penal, pavarësisht rezultatit të gjithë procedimet penal apo vendimit që merret aty. Nëse gjykata vendos fakte brenda këtij vendimi, të cilat përcaktojnë gjithashtu arsyet e forta për një sanksion disiplinor, kjo është e mjaftueshme për trupat disiplinore që të vazhdojnë me këtë sanksion.

Fatmir Xhafaj – Ajo që unë nuk kuptoj është se çfarë rëndësie kanë faktet. Neve na intereson nëse është dënuar apo nuk është dënuar. Kaq na intereson. Nuk ka rëndësi çfarë faktesh përmend gjykata në arsyetimin e vendimit që e kanë çuar atë në ndëshkimin penal.

Çfarë lidhjeje kanë faktet, që e kanë çuar gjykatën në ndëshkimin penal të magjistratit, me disiplinën? Ne e ndëshkojmë disiplinarisht, në qoftë se ai është ndëshkuar penalisht. Këtu mbarojmë ne. E marrim të mirëqenë vendimin ne, pra nuk arsyetojmë nëse disa fakte janë të buta dhe disa të rënda.

Vasilika Hysi – Po e diskutoja edhe me zotin Vasili, jo të gjitha veprat penale janë kaq të rënda. Ne kemi në Kodin Penal kundërvajtje penale, për shembull, “drejtimi i automjetit në gjendje të dehur”...

Fatmir Xhafaj – Mirë, pra, ndaje në varësi me llojin e veprës penale.

Vasilika Hysi – Nëse një magjirat dënohet për veprën penale “drejtimi i automjetit në gjendje të dehur”...

Fatmir Xhafaj – Jo, faktet, pra.

Vasilika Hysi – Është vepër penale, por besimi i publikut nuk është cenuar aq rëndë si në rastin e një korrupsioni, e një shpërdorimi detyre apo i një vepre tjetër.

Fatmir Xhafaj – Të riformulohet i gjithë neni 104.

(Diskutime pa mikrofon.)

Neni 105 “Masat disiplinore”. A jeni dakord? Dakord.

Neni 106 “Vërejtje konfidenciale”. A jeni dakord? Dakord.

Neni 107 “Vërejtja publike”. A jeni dakord? Dakord.

Neni 108. Dakord?

Pandeli Majko – Kam një pyetje te pika 1 e nenit 106: “Vërejtje konfidenciale është një masë disiplinore jopublike e njohur për magjistratin, e cila vërteton jopublikisht...” Dihet që është jopublikisht, se ashtu nis fjalia, pra duhet “e cila vërteton kryerjen e sjelljes së papërshtatshme”. Nuk duhet të vendoset dy herë brenda fjalisë fjala “jopublike”.

Vasilika Hysi – Zoti Majko, fjalët “e cila vërteton jopublikisht” është një sjellje që nuk ka rënë në sy të publikut, por lidhet me punën e tij të përditshme, pra nuk është një shkelje që e ka bërë në publik dhe i jepet vërejtje konfidenciale...

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Ka të drejtë. Është thënë një herë.

Nenet 106 dhe 107 i kaluam.

Neni 108. A jeni dakord? Dakord.

Neni 109 “Ulja në detyrë”. A jeni dakord? Dakord.

Neni 110 “Pezullimi si masë disiplinore”. A jeni dakord? Dakord.

Neni 111 “Shkarkimi”.

Vasilika Hysi – Sugjeroj të riformulojmë germën “b”, paragrafi 1, ku thuhet: “Për një sjellje të kryer me pakujdesi të rëndë dhe që shkel haptazi vlerat themelore të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë”, pra të heqim fjalën “të paktën”.

Petrit Vasili – Ka një problem: një nga gjërat që do detajim këtu është, se kjo është marrëdhënie e drejtpërdrejtë, neni 108 “Ulja e përkohshme e pagës”, herë është dhënë masë deri në 40%. Në qoftë se ka vend ku duhet një lloj interpretimi, ky është. Këtu me pagën mund të abuzohet si të duash, njërit i bëhet një ulje simbolike, si të dojë, 5%, kurse një tjetri ia mban rrogën për një vit rresht 40%. Nuk e di se ku ankohen këta, por kjo kërkon një lloj detajimi, sepse mund të bëhet shumë kollaj objekt abuzimi. Të jeni të bindur për këtë. Këto të tjerat janë të qarta, sepse, në fund të fundit, vlerësime janë. Duhet një lloj detajimi këtu.

Fatmir Xhafaj – Do një lloj detajimi në raport me shkeljen. Ai që ka marrë vërejtje konfidenciale nuk i shkon deri në 40%; ai që ka marrë një vërejte publike...

Petrit Vasili – Duhet bërë një shkallëzim këtu, sepse është problem financiar

Fatmir Xhafaj – Që lidhet me llojin e shkeljes. A jeni dakord? Dakord.

Neni 111 miratohet me sugjerimet që bëri zonja Hysi.

Neni 112 “Masa disiplinore përjashtuese”. Dakord.

Neni 113 “Masat plotësuese për trajnim”. Dakord.

Neni 114 “Ulja në detyrë e kryetarit”. Kryetari nuk ulet në detyrë, por hiqet nga detyra. Bëhet zëvendëskryetar?

Agnes Bernhard – (*Flet për kthyesja*) Pra, kjo është vetëm në rolin apo pozicionin e kryetarit. Ai mund të jetë një gjyqtar shumë i mirë, por funksionin e kryetarit nuk e kryen mirë.

Fatmir Xhafaj – Nuk ulet. Kur thuhet ulet, do të thotë që nga klasa A shkon në klasën B, lirohet nga detyra. Pra, masë plotësuese është largimi i kryetarit nga detyra...

Petrit Vasili – Pika 1 e nenit 112, që i referohet nenit 114, thotë: “Këshilli vendos masë disiplinore plotësuese, krahas masës disiplinore, në rastin e shkarkimit duke i kërkuar kthimin e pagës në vlerën 50% të dy vjetëve pasuese, nëse magjistrati është dënuar me vendim të formës së prerë për veprën penale në fushë e korrupsionit”. Çfarë page? Nëse ai dënohet për korrupsion, ai ikën nga puna. Si mund të jetë i dënuar për një vepër penale në fushën e korrupsionit, ai vazhdon e merr pagë, por merr vetëm gjysmën e pagës dhe jo pagën e plotë? Ma shpjegoni këtë gjë, se unë nuk e kuptoj dot.

Vasilika Hysi – Çështjen që ngriti zoti Vasili e kam edhe unë. E kemi diskutuar gjatë edhe para mbledhjes me zonjën Agnese, pasi në përgjithësi, kur fillon një procedim penal ndaj një gjyqtari ose prokurori dhe kur ka masa disiplinore, paga nuk pezullohet, pra

paga ecën. Shqetësimi që unë ngrita është se kjo krijon një pabarazi. Në rast se në administratën publike dikush arrestohet dhe është në paraburgim, në hetim, nuk merr pagë. Zonja Agnese thotë se kjo procedurë që ne ndjekim në vendin tonë nuk është në përputhje me standardet europiane. Shqetësimi që ngre zoti Vasili do të gjejmë në nenet që do të pasojnë diskutimin. Ky është edhe shqetësimi im dhe pajtohem me atë që thotë zoti Vasili. Një njeri që procedohet penalisht për korrupsion, për vrasje, gjyqtar apo prokuror, si mund të marrë 100% të pagës dhe...

Petrit Vasili – Nuk procedohet, Vasilika.

Vasilika Hysi – Pastaj kthen vetëm 50% kur dënohet.

Petrit Vasili – Jo, thuhet “nëse magjistrati është dënuar me vendim të formës së prerë. Ky njeri, që është dënuar me vendim të formës së prerë, nuk merr fare pagë, por shkon në burg.

Fatmir Xhafaj – Cili është kuptimi që keni dashur t’i jepni?

Agnes Bernhard – (*Flet përkthyesja*) Nëse një gjyqtar dënohet nga gjykata për korrupsion, atëherë ai thjesht ka një dënim, i cili jepet nga gjykata, dhe ne nuk jemi të interesuar për këto sanksione penale apo sanksione që janë në këtë ligj. Sigurisht, pavarësisht këtyre sanksioneve penale për shkak të korrupsionit, këshilli duhet të shikojë edhe aspektet disiplinore që lidhen me këtë gjë. Një çështje korrupsioni do të çojë në largimin nga puna dhe gjyqtari jo vetëm do të largohet nga puna, por, përveç kësaj, ai do të paguajë për dy vjet 50% të pagës së tij. Pra, thelbi kryesor qëndron te vendimi penal që do të merret, më pas është masa disiplinore, pastaj pagesa që ai duhet të bëjë.

Fatmir Xhafaj – Në qoftë se është dënuar, ai do të ikë dhe mbaroi. Tani do të kthejë edhe lekët për këtë gjë. Në burg ai nuk ka marrë rrogë.

Petrit Vasili – Këto lloj përcaktimesh në nen na heqin thelbin e kësaj çështjeje. Shiko se çfarë thuhet në pikën 2: “Këshilli, përveç masave, meqë ky doli me vendim të formës së prerë (thoshte pika më lart), kërkon ndjekjen e detyrueshme të trajnimeve nga magjistrati.” Ky është i korruptuar, kurse ne kemi hall si do ta trajtohet më tutje? Apo kërkohet ulja në detyrë nga pozicioni i kryetarit në atë të magjistratit të zakonshëm? Neni 112 duhet parë...

Vasilika Hysi – Paragrafi i dytë nuk ka lidhje me të dënuarin, për të tjerët...

Petrit Vasili – Përveç masave të parashikuara në pikën 1 të nenit 105, ligji mund të vendosë edhe masa disiplinore. E lexon mirë, ti, apo jo? Kjo duhet rishkruar komplet.

Fatmir Xhafaj – Hiqeni këtë pikën e pagës, se do të lëmë nam atje dhe do të thonë se 50% jua lanë atyre që janë të dënuar...

Etilda Saliu – Edhe te ligji për nëpunësit civilë ka një standard të ngjashëm, nuk është identik. Janë në disa raste, për shembull, te ligji “Për nëpunësi civilë” thuhet se personi merr pagën e plotë në rastet kur pezullimi është vendosur si masë ndaluese nga gjykata. Pra, ka elemente të tilla. Ose për shembull, merr 50% të pagës në rastin e një procedimi disiplinor dhe këto janë te ligji për nëpunësin civil.

Fatmir Xhafaj – Mirë, pra, por kjo është gjë tjetër, se këtu po flasim për dënimin, kështu që rregullojeni këtë.

Etilda Saliu – E kuptoj, por kur është vendosur si masë ndaluese nga gjykata.

Fatmir Xhafaj – Riformulojeni nenin 112...

Petrit Vasili – Sugjerim: kudo që ka prekje të pagës, le të futet te neni përkatës te uljet e përkohshme të pagës. Ne kemi një nen më vete për këtë punë. Në rastin e ndjekjes merr kaq lekë etj. Të mos ngatërrohem me këtë histori.

Fatmir Xhafaj – Hiqini edhe këto referencat “germa “a”, pika 2 e nenit 112” etj. Këshilli vendos masën disiplinore në rastet plotësuese edhe për trajnimin, për uljen në detyrë. Përmblihdhini të gjitha në një.

Vasilika Hysi – Referenca duhet, por duhet të ndryshojmë mënyrën e të shkruarit. Pra, do ta lëmë sipas parashikimeve të pikës... Pra, nuk do të fillojë kështu siç është fjalia. Kjo është një çështje e redaktimit, pa ndryshuar përmbajtjen.

Fatmir Xhafaj – Të gjithë këtë pjesën e këtij kapitulli duhet ta riformulojmë edhe në pikëpamje të teknikës legjislative, që të mos lëmë gjëra evazive; kuptohet sa të mundemi.

Neni 115.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vasilika Hysi – Kjo i jep fund subjektivizmit, sepse përcakton se cilat janë rrethanat lehtësuese, rënduese dhe çfarë mban parasysh këshilli, i cili ka disa alternativa, prandaj thuhet “mund të vendosë”, sepse mund të vendosë njërin nga këto masa dhe sesi i vendos për t’i dhënë fund subjektivizmit, këtu janë përcaktuar rrethanat rënduese apo lehtësuese. Është gjë shumë e mirë që kriteret janë të qarta në ligj, sepse deri më sot nuk ka pasur fare kriterë. Këshilli i Lartë i Drejtësisë ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë përzgjidhte një prej masave, pa ditur mbi cilat kriterë. Prandaj, shqetësimi që ngriti zoti Majko për përdorimin e foljes gjysmëndihmëse “mund”, se mund të vendosë një prej masave, pra nuk është e thënë t’i vendosë të gjitha, bazuar në kriteret për caktimin e masës disiplinore.

Petrit Vasili – Sugjerim për germën “e” të nenit 115: “Rrethanat personale të magistratit duke përfshirë edhe ato për shëndetin fizik ose mendor...”. Në këtë pikë nuk jemi fare të qartë për këtë gjë. Mund të pranojmë të themi rrethanat që lidhen me shëndetin

mendor, pasi mund të ndodhë një çrregullim i çastit, që zbulohet në moment dhe duhet të merret në konsideratë. Për sa i takon shëndetit fizik, kjo nuk mund të ketë lidhje me ushtrimin e veprimtarisë, shëndet fizik nënkupton ose ka pamundësi për të mos e ushtruar fare veprimtarinë, pra nuk mund të shkosh në punë, se, po shkove, nuk e afekton arsyetimin arsyetimin mendor. Kështu që rrethanat e shëndetit fizik mund të kthehen lehtë në një mundësi shumë të madhe abuzimi për t'i shkarë përgjegjësisë. Për shëndetin mendor kam rezerva të mëdha, sepse ky është një vlerësim që duhet bërë paraprakisht, por hajde të pranojmë rrethanën e jashtëzakonshme, që ndodhë ndonjëherë në mjekësi, pra që kjo çështje u verifikua krejt papritur, se ndodhi në ato momente dhe doli një sëmundje e fshehur mendore, duke afektuar arsyetimin nga ana mendore. Shëndeti fizik nuk mund të përdoret si një rrethanë lehtësuese në çështjen e masës disiplinore.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Majko.

Pandeli Majko – Fola “out off records” për atë problemin e foljes “mund” dhe nga neni 115 po kaloj te nenet 114, 113, 112, që lidhet me pikën 1 të nenit 105. Ku e kam fjalën (kërkoj mirëkuptimin e specialistëve, ju jeni më të qartë se të gjithë në kuptimin e ekspertizës): po ndërtoj një institucion të ri, tani ky institucion do të ndërtojë rregulla standarde për të qenë vazhdimësi murale e Këshillit të Lartë të Drejtësisë apo do të ketë disa standarde shumë të qarta, sepse të pika 1 e nenit 105 ju keni edhe vërejtjen konfidenciale, edhe vërejtjen publike, edhe uljen e përkohshme të pagës, edhe uljen në detyrë, edhe pezullimin nga detyra, edhe shkarkimin nga detyra? Për pikën 1 të nenit 105 ju na thoni se këshilli, bazuar në pikën 1, mund të vendosë një nga këto masa disiplinore shtesë: “ndjekjen e detyrueshme të trajnimeve të specifikuar nga magjistrati”, “uljen në detyrë nga pozicioni i kryetarit në atë magjistratit”. Më falni, po flasim për një gamë shumë të gjerë disiplinore dhe ju na thoni se mund të vendosni ndjekjen e detyrueshme të trajnimeve të specifikuar nga magjistrati, mbi ç’logjike? Mua më duket se këtu gjithçka është subjektive. M’u mund të shkarkosh me germën “dh”, ku është “shkarkimi nga detyra”, pastaj të marrësh edhe një masë disiplinore dhe të më çosh për “ndjekje të detyrueshme të trajnimeve të specifikuar të magjistratit”, më mban brenda sistemit. Më falni, po e trash shumë mënyrën naive të të parit të gjerave, sepse dua të di se ku shkon subjektivizmi i një këshilli, që do të mbrojë Pandeli Majkon, sepse të paktën, sa mund të jenë aty prezentë, gjysmën i kam shokë, kam ngrënë dreka dhe dark, kështu që do të bëjnë të pamundurën të më mbajnë brenda sistemit dhe jo të më largojnë. Mund të kem bërë budallallëkun më të madh. Kush e ka ngrënë sistemin e drejtësisë sot?! Rrethanat miqësore, sepse e njohim të gjithë njëri-tjetrit, sepse jemi ulur për dreka, për darka, në dasma, në hidhërime apo gëzime. Madje, kemi ndarë edhe ndonjë biznes

të përbashkët. Prandaj e shoh si problem unë këtë foljen “mund” dhe të gamës së gjerë... Çfarë do të ndodhë? I gjithë shqetësimi ynë është se po krijojmë institucione pa të kaluar; nuk kanë asnjë memorie. Çfarë memorieje do të vendosin këtë me këto masa disiplinore që po organizojnë? Si do të orientohet ai në marrëdhëniet me shkeljet e disiplinës, apo do të vazhdojmë të jemi një inerci e vendimmarrjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ku vajti gjyqtari dhe tha: “Më falni, e kam një vilë të fshehur, por e kam të të dashurës dhe nuk mund ta deklaroj” dhe vazhdoi të punonte si gjykatës. Pastaj, të përdorim këtë nenin 114 “Ulja në detyrë” me “nuk justifikon vazhdimin në detyrë”. Si “nuk e justifikon vazhdimin në detyrë”? Në marrëdhënie me një shkelje disiplinore nuk ekziston shprehja “nuk justifikon”, të paktën në termat e gjuhës shqipe. Shkelja disiplinore nuk ka raport me mbajtjen e vendit të punës me termin “nuk justifikon”. Ti e meriton, ose nuk e meriton, vazhdon ose nuk vazhdon në atë vend pune. E gjithë kjo ka të bëjë me shqetësimin: po krijojmë standarde disiplinore, apo po krijojmë vrima për të kaluar minjtë e mëdhenj?!

Agnes Bernhard – (*Flet përkthyesja*) Në fakt, kjo është një pyetje mjaft e gjerë dhe është diskutuar në komision dhe në gjitha takimet tona dhe mënyra si jemi përpjekur t’i japim një përgjigje është në vazhden e dy qasjeve që ekzistojnë edhe në Europë: e para, parashikohet një katalog i të gjitha shkeljeve që mund të ndodhin dhe, sipas këtyre shkeljeve, janë edhe masat që mbështetin këtë shkelje, por është mjaft e vështirë për të kategorizuar, për të klasifikuar se cilat shkelje meritojnë apo mund të përshtatën me çfarëdolloj sanksioni. Për shembull, nëse një magjistrat do të marrë një dhuratë, atëherë është një shkelje e cila ka si masë shkarkimin nga puna; nëse një gjyqtar do të pijë kafe me dikë pa e ditur që ai është pjesë e një procesi gjyqësor, apo palë e procesit gjyqësor, atëherë mund t’i bëjmë thjesht një paralajmërim; nëse një magjistrat do të kryejë një shkelje të tillë që do të marrë 1 mijë euro, atëherë sanksioni që do të marrë është shkarkimi nga puna, pra këtë gjë meriton. Për këtë arsye ne menduam të miratojmë apo të përdorim atë model, i cili përdoret edhe në shumë vende të tjera, ku parashikohet një listë e detajuar e të gjitha shkeljeve dhe faktorëve, të cilët duhen marrë parasysh nëse veprime të caktuara mund të quhen si veprime të rënda, më pak të rënda apo shumë të rënda.

Pandeli Majko – Jam shumë dakord me atë që dëgjova për sa i përket kategorizimit të rrethanave lehtësuese.

Te neni 112 “Ndjekja e detyrueshme e trajnimeve të specifikuar nga magjistrati”. Më falni për “injurancën naive”, po çfarë janë “trajnimet e specifikuar nga magjistrati”? Ka shkolla trajnime të kategorizuara për shkeljet disiplinore?

Unë kam një merak: për çfarë kategorie masash disiplinore do të bëhet ky lloj trajnimi? Ju e keni thënë pika 1, por pika 1 është e gjerë, është nga “Vërejtje konfidenciale” deri te “Shkarkimi nga detyra”. Unë kam frikë se kjo puna e trajnimeve do të jetë si para viteve '90, njëlloj stazhi. Ky trajnim do të përdoret si një kazus për ta mbajtur një njeri që ka rreth konfidencial brenda sistemit dhe atij, që nuk ka rreth konfidencial, do t'i thotë ik në shtëpi. Mua këtu më trishton kjo fjala “mund”. Më kuptoni, sepse mund të kemi për dy njerëz të ndryshim vendime të ndryshme, në kohë të ndryshme. Këtë e kam merak unë.

Fatmir Xhafaj – Shqetësimi është i ligjshëm, që të kemi sa më pak mundësi abuzive në vlerësim. Kështu që edhe një herë në zbardhje, nëse ka ndonjë paragraf që ndihmon abuzivitetin të jemi të kujdesshëm të heqim fjalët e tepërta. Subjektivitet do të ketë, kjo është normale, sepse vlerësim është në finale, por e rëndësishme është që ky të mos jetë abuziv.

Pandeli Majko – Po e specifikoj, zoti kryetar.

Domethënë, te pika 1 e nenit 105, ku citohet te neni 112, të mos përfshihet germa “dh” që është “Shkarkim nga detyra”. Po u shkarkua nga detyra, nuk mund të shkojë më në trajnim. Ndajeni, ose do ta shkarkoni, ose nuk do ta shkarkoni. Një njeri që e shkarkon, nuk ka kuptim ta mbash brenda sistemit. Ndryshe, kjo historia e shkarkimeve do të bëhet: “Po të shkarkoj, por po të mbaj”. Pra, germa “dh” nuk ka kuptim aty.

Fatmir Xhafaj – Pra, kjo ka nevojë për një rishikim.

Dakord.

Faleminderit!

Neni 116 “Masat për shmangien e vonesave”. Dakord.

Vazhdojmë me “Procedurat hetimore”. “Afatet e parashkrimit”.

Vasilika Hysi – Janë bërë disa saktësime për përllogaritjen e afateve: kur parashkruhet shkelja disiplinore; dallimi kur shkelja përbën vepër penale, duke iu referuar që afatet do të ecin sipas Kodit Penal; kur fillon përllogaritja e afatit të parashkrimit, sepse nuk ka qenë të qartësuara.

Fatmir Xhafaj – Saktë.

Dakord.

“Afatet e procedimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Vasilika Hysi – Këtu ka pasur një diskutim shumë të madh, nëse ju kujtohet, zot kryetar, pra brenda sa kohësh, sa muaj nga dita e marrjes së vendimit për fillimin e hetimit inspektori mund të fillojë procedimin disiplinor. Është bërë një plotësim në paragrafin 5 se çfarë ndodh nëse inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk zbaton afatet.,

Fatmir Xhafaj – Është në rregull.

Miratohet, me ndryshimin e bërë.

Neni 119 “Ankesat”.

Vasilika Hysi – Është mënyra e trajtimit të ankesës nga inspektori. Siç e dini, në Kushtetutë është thënë: “Kompetenca e Inspektorit të Lartë”. Këtu rregulloret se kush ka të drejtë të paraqesë ankesa.

Në lidhje me terminologjinë, janë çështje të redaktimit.

Fatmir Xhafaj – Jemi dakord me ndryshimet.

Neni 120 “Kriteret për pranueshmërinë e ankesës”. Jemi dakord me ndryshimet.

Neni 121.

Dakord me ndryshimet që janë paraqitur në këtë tekst.

Neni 122 “Verifikimi i ankesës, dakord me ndryshimet.

Neni 123 “Vendimi i fillimit të hetimit me nismë të ankuesit”.

Vasilika Hysi – Është shtuar një paragraf i katërt, në rastet kur shkelja ka të bëjë me sjellje ose veprime të përsëritura, që është objekt hetimi.

Fatmir Xhafaj – Dakord me shtesën e bërë, e kemi përpara të gjithë dhe besoj se është e qartë.

Neni 124 “Fillimi i hetimeve me iniciativën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Dakord me rregullimet e bëra, të cilat janë kryesisht të natyrës redaktoriale, siç i keni në tekstet përpara.

Neni 125 “Shtimi ose ndryshimi i objektit të hetimit”.

Dakord me ndërhyrjet redaktoriale.

Neni 126 “Pezullimi i hetimeve”.

Edhe këtu shoh që ka ndërhyrje të natyrës redaktoriale.

Ka tjetër? Nuk ka. Dakord.

Neni 127 “Kërkesa për pezullimin e magjistratit”.

Dakord.

Neni 128 “Bashkimi i procedimeve hetimore”.

Dakord.

Neni 129 “Të drejtat dhe detyrimet e magjistratit gjatë hetimit”.

Është shtuar një pikë 3 për njoftimin që duhet t’i bëjë Inspektorati i Lartë i Drejtësisë inspektorit, magjistratit ose përfaqësuesit të tij. Dakord.

Vasilika Hysi –Kemi pasur një diskutim të gjerë me ekspertët nëse duhet të përsërisim në këtë ligj të drejtën e magjistratit për të ushtruar ankimimin. Ndaj, për shembull,

për rastin kur inspektori arkivon, shton apo ndryshon objektin e hetimit, zonja Agnes thotë se ky është një parim i përgjithshëm i parashikuar në ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” dhe nuk është e nevojshme të përsëritet...

Fatmir Xhafaj – Përderisa është atje nuk kemi pse e përsërisim.

Vasilika Hysi – Më falni, te ligji “Për qeverisjen e sistemit të drejtësisë” dhe nuk është e nevojshme, pra nënkuptohet.

Fatmir Xhafaj - Dakord, proces administrativ është, për zbatimin e rregullave dhe kodet e procedurës administrative.

Etilda Saliu – Te ligji “Për qeverisjen e sistemit gjyqësor” është parashikuar shprehimisht se “vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor janë të ankimueshme” dhe ne i jemi referuar atij rregulli të përgjithshëm pa përsëritur të njëjtën gjë.

Fatmir Xhafaj – Të mos e përsërisim. Dakord.

Neni 130 “Ecuria e hetimeve”.

Dakord me ndryshimet që janë bërë këtu.

Neni 131 “Kërkesat për marrjen në pyetje”.

Dakord me ndërhyrjet, në tekst që janë të natyrës redaktoriale.

Neni 132 “Kërkesat në lidhje me mbledhjen e pronave dhe institucione të tjera”.

Dakord me ndërhyrjet e natyrës redaktoriale.

Neni 133 “Dokumentacioni i hetimit”.

Dakord, gjithashtu, me ndërhyrjet redaktoriale të teknikës legjislative.

Neni 134 “Mbyllja e hetimit”.

Dakord me reflektimet që janë bërë.

Neni 135 “Marrëveshja e pëlqimit të përbashkët”.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Petrit Vasili – Këtu do të na hynin në punë njerëz që redaktojnë. Pëlqimi është një rrethanë kënaqësie, nuk është në rrethana faji.

Pandeli Majko – Parlamenti jep pëlqimin. E keni lexuar në Kushtetutë.

Petrit Vasili – Edhe pëlqimi tregon kënaqësi.

Vasilika Hysi – “Palët bien dakord”, ja ku e ke.

Fatmir Xhafaj – E pranojnë, sepse pëlqimi i bie “të pëlqehemi ne të dy”. Ne pëlqehemi, por ka konotacion tjetër.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, shqetësimi që keni ju zgjidhet në paragrafin e dytë kur thuhet “Palët mund të bien dakord për llojin e shkeljes disiplinore që magjistrati pranon, si edhe për masën disiplinore”. Të ndryshojmë titullin.

Fatmir Xhafaj – Marrëveshjen e pranimit të përbashkët. Dakord me nenin 135.

(Mungesë audio).

Etilda Saliu – Jo, vetëm në qoftë se këshilli e pranon marrëveshjen.

Gent Ibrahim – Marrëveshja duhet pranuar nga këshilli për çdo rast.

(Mungesë audio).

Vasilika Hysi –Te sistemi i menaxhimit të çështjeve kam merakun e foljes që “Inspektori i Lartë i Drejtësisë krijon sistemin e menaxhimit të çështjeve”. Nuk e di si është lënë tani përfundimisht pas detyrës që u la te ligji i qeverisjes...

Fatmir Xhafaj – Këtu është menaxhimi i çështjeve të procedurës hetimore, ndërsa ai është menaxhimi i çështjeve gjyqësore. Pra, janë dy....

Këtu kemi të bëjmë me sistemin e menaxhimit të çështjeve për procedurën hetimore. Mund t’i gjeni diçka tjetër, që të mund të mos konfondohen si terminologji, “Sistemi i administrimit të çështjeve”. Ai administron dosjet.

(Diskutime pa mikrofon).

Pandeli Majko – Do të propozoja që te sistemi i menaxhimit, edhe në funksion të standartizimit të masave disiplinore në vazhdim, se do të krijohet një memorie...

Fatmir Xhafaj – Administrim (*data basë*) është .

Pandeli Majko – Çështjet të numërtohen dhe kur diskutohet në këshill për çështje të natyrave të ndryshme, shumë standarde disiplinore të vendosura mund të citohen thjesht sipas çështjes 116/1 etj., kam parasysh përvojën e nënseksionit në diskutimin e precedentëve. Kam përshtypjen se kjo më së shumti do të jetë në funksion të ndërtimit të precedentëve dhe të standartizimit të masave disiplinore, apo jo? Ky sistem menaxhimi këtu do ta ketë efektin bazë, sepse nuk do të jetë thjesht memorie arkivore.

Fatmir Xhafaj – Zonja Bernhard, fjala për ju.

Agnes Bernhard – (*Flet përkthyesja*) Do të sugjeroja që të përdornim të njëjtën terminologji, siç e kemi në ligjin e qeverisjes.

Fatmir Xhafaj – Dakord, akoma më mirë që t’i kemi në mënyrë të unifikuar.

Dakord me nenin 137 me ndryshimet, qoftë në emrin tim edhe me ndërhyrjet që u bënë.

Vazhdojmë me Kreun III – “Fillimi i procedimit disiplinor”.

Neni 138 “Fillimi i procedurës disiplinore”.

Vasilika Hysi – Janë saktësimet që kemi kërkuar ne për ta pasur sa më të qartë rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Nuk shoh ndryshime të tjera.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Faleminderit!

Neni 139 “Mbyllja e procesit disiplinor pas seancës disiplinore”.

Vasilika Hysi – Është saktësim i terminologjisë për të mos lënë nënkuptime.

Fatmir Xhafaj – Neni 139.

Dakord.

Neni 140 “Shtimi i procedimeve disiplinore”.

Dakord.

Neni 141.

Dakord.

Neni 142 “Seanca disiplinore”.

Dakord.

Neni 143 “Shtyrja e seancës dëgjimore”.

Vasilika Hysi – Te paragrafi 3, në vend të fjalës “shkaqe” paraqet argumente se shkelja disiplinore është kryer, jo shkaqet. Pra, Inspektori i Lartë i Drejtësisë paraqet “shkaqet”, duhet të themi “argumentet”.

Fatmir Xhafaj – Te neni 142 e keni fjalën? Dakord.

Neni 144 “Ndryshimi ose shtimi i objektit të procedimit disiplinor”.

Dakord.

Neni 145 “Pezullimi i procedimit disiplinor”.

Dakord.

Neni 146 “Vendimet e këshillit për çështjet e disiplinës”.

Dakord.

Neni 147 “E drejta e ankimit për vendimet disiplinore”.

Vasilika Hysi – Dakord, dhe kjo zgjidh edhe shqetësimin e ankimit që ne patëm.

Fatmir Xhafaj – Po, patjetër.

Kreu IV – Ekzekutimi dhe regjistri.

Neni 148 “Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë”.

Dakord.

Neni 149 “Publikimi i vendimeve disiplinore”.

Lini një afat këtu për publikimin e vendimeve.

Pandeli Majko - Brenda një muaji ose 45 ditëve.

Fatmir Xhafaj – Dakord neni 149 me ndryshimet.

Neni 150 “Regjistri dhe të dhënat disiplinore”.

Dakord?

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, këtu ka disa masa disiplinore fshirje, periudha kur përlllogaritet, kur masa shuhet dhe fshihet nga regjistri.

Fatmir Xhafaj – Normale, nuk mund t'i rrijë një vërejtje kofidenciale gjithë jetën njeriut.

Petrit Vasili - Përse thuhet “të dhëna disiplinore” përse nuk themi “masë”, sepse i gjithë ligji referon vetëm “masën”?

(Diskutim pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – E lëmë “Regjistri disiplinor”, si saktësim titulli. Është korrekte. Të mos vëmë fjalë parazitare në tekst.

Kreu V – “Pezullimi”

Neni 151 “Pezullimi i detyruar”.

Dakord me ndryshimet.

Neni 152 “Pezullimi mbi bazë diskrecioni”.

Dakord.

Vasilika Hysi – Kishim një diskutim për germën “b” të paragrafit 1 ku thuhet: “Magjistrati merret në cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer nga pakujdesia”. Një pjesë e ekspertëve mendojnë që nuk ka term “krimi i rëndë i kryer nga pakujdesia”, sepse...

Fatmir Xhafaj – Po, ka.

Vasilika Hysi –Unë them që në Kodin Penal ka, për shembull, “vrasja është krim i rëndë i kryer nga pakujdesia”, prandaj unë personalisht nuk gjej ndonjë problem, por një pjesë e ekspertëve, sidomos e magjistratëve, që janë konsultuar, thonë se mund të jetë subjektive.

Petrit Vasili - Po në rrethana krimi të kryer nga pakujdesia?

Fatmir Xhafaj – Do ta marrim në konsideratë? Dakord neni 152.

(Mungesë audio).

Neni 153 “Fillimi i procedimit të pezullimit”.

Dakord.

Neni 154 “Njoftime për këshillin”.

Dakord.

Neni 155 “Vendimet e pezullimit dhe ankimet”.

Dakord.

Neni 156 “Kufijtë e kohëzgjatjes së pezullimit”.

Dakord.

Neni 157 “Pezullimi i pagës dhe përfitimeve”.

Vasilika Hysi – Kjo është çështja për të cilën ne filluam diskutimet te masat plotësuese. Magjistrati përfiton pagën e plotë gjatë pezullimit nga detyra, përveçse kur parashikohet ndryshe në përcaktimet e mëposhtme të këtij neni, dhe në paragrafin e dytë të këtij neni thuhet: “Kur magjistrati dënohet për kryerjen e një veprë penale nga Gjykata e Shkallës së Parë, jo vendim i formës së prerë, ose jepet një masë disiplinore për shkelje nga këshilli, mund të pezullojë përfitimin e pagës deri në 50%”, pra jo detyrimisht mund të pezullohet dhe përfitimet e tjera deri sa të vendoset mbi ankimin.

Kam pasur një diskutim të gjatë me zonjën Agnes, para mbledhjes dhe nuk dua ta përsëris atë që thanë zoti Vasilli dhe kolegu Majko, si ka mundësi që një person që është në procedim, madje që dënohet, të merrë rrogën e plotë, ose maksimumi që mund të bëhet është të pezullohet paga deri në masën 50 % të përfitimit. Zonja Agnes thotë ky është standard...

Fatmir Xhafaj – Dakord, por edhe nëse unë kam nisur një procedurë disiplinore, pagën do ta marr unë, procedurë disiplinore është ajo.

Petrit Vasili -Mund ta sqaroj pozicionin? Ky parashikim këtu është korrekt, por tek ai nen ku citohet duhet të plotësohet me këtë që ka thënë “Deri sa të vendoset mbi ankimin e paraqitur në gjykatën më të lartë”, sepse aty ishin lënë pezull dhe ishte dhënë përcaktimi që ky është dënuar për veprën e korrupsionit. Në atë nen, po t’i ktheheni, do të thotë se ky e ka marrë dënimin, ne themi pse merr pagën, kurse në rastin konkret thotë: “Është prezumuar edhe pafajësia”, këtë kuptoj unë nga kjo që thuhet, dhe deri në mbarimin e gjykimit mund të kem këtë gjykim, madje nuk ka ndonjë problem të madh. Kjo këtu është korrekt, jam dakord, por atje e kishin lënë të prerë.

Fatmir Xhafaj – Nenin 105 do ta rishikojmë, do të merrem unë vetë.

(Mungesë audio).

Neni 158.

Dakord.

Vasilika Hysi –Për herë të parë parashikohet përgjegjësia civile. Patëm një diskutim me zonjën Agnes, sepse si rregull, magjistrati nuk ka përgjegjësi civile për shkak të ushtrimit të funksionit të tij, përveç rasteve kur ka tregues të pakujdesisë së rëndë, thuhet në këtë nen duke hequr shprehjen “të paktën”.

Ky nocion futet për herë të parë, dhe zonja Agnes kishte disa argumente që më bindën se nuk mund të lihen pa asnjë përgjegjësi civile. Kur vendimet janë haptas tregojnë se ka treguar pakujdesi, dhe prej saj mund të kenë ardhur pasoja. Besoj se zonja Agnes mund të

na e sqarojë më mirë për t'i ruajtur si rekorde të mëtejshme, si dhe për anëtarët e tjerë të komisionit.

Agnes Bernhard – *(flet përkthyesja)* Normalisht, si rregull gjyqtari nuk duhet të mbajë përgjegjësi civile për ato çështje, të cilat janë pjesë e gjykatës, por për çështje, të cilat një gjykatës apo gjyqtar ka bërë një gabim dhe qytetari e ka fituar si çështje, atëherë ky gjykatës duhet të mbajë një përgjegjësi.

E diskutuam nëse do të ishte diçka e mirë dhe e zgjuar për ta vendosur në Shqipëri, duke pasur parasysh edhe gamën e gjerë të Kodit Civil apo të së Drejtës Civile.

Në ato vende ku vendosen këto kufizime të së Drejtës Civile, ka edhe ligje të veçanta përkatëse që përputhen me përgjegjësinë civile.

Fatmir Xhafaj – Biem dakord për këtë.

Faleminderit!

Kapitulli VI - “Dispozitat e fundit dhe kalimtare”.

“Organet kompetente në periudhën tranzitore”.

Këta do të fillojnë ta implementojnë këtë?

Agnes Bernhard – *(flet përkthyesja)* Pra, do të thotë që ky ligj sapo të hyjë në fuqi, do të fillojë të zbatohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nga Prokuroria e Përgjithshme dhe nga inspektoratet. Duhet të fillojnë zbatimet, pavarësisht se ky ligj u referohet këshillave të lartë gjyqësor apo të këshillave të lartë prokurorial.

Fatmir Xhafaj – Kjo është pak problematike, sepse i bie që te Këshilli i Lartë të gjejë ca gjëra të gatshme dhe atje të mos dijë nga të orientohet. Këta janë në ikje e sipër, kjo është një periudhë tranzitore, duhet të jemi të kujdesshëm në këtë gjë. I lë një mal me probleme dhe na rroftë ne. Mund ta komprometojë të gjithë ngritjen e këshillit të ri.

Do një rregullim kjo. A mund ta rishikojmë? Për një pjesë të kufizuar, sepse në qoftë se ai fillon ngritjen në detyrë, vë kryetarët e gjykatave e të gjitha dhe pastaj, kur të vijë ai, thotë për 6 muaj mbaruan të gjitha këto. Pra, është periudhë tranzitore, duhet të ketë disa përgjegjësi të kufizuara, sepse ne po bëjmë një reformë tërësore, po ngremë disa institucione të reja, që do të thotë se do të ketë përgjegjësi të reja, që do të duhet që ata t'i marrin mbi vete me një frymë të re. Për shembull, ato që ka Inspektori i Lartë i Drejtësisë t'i fillojë t'i bëjë inspektorati që është sot, që ka të paktën 8 vjet, në mos më shumë, 10 vjet, që nuk ka lëvizur asnjë gjë nga vendi. Nuk kemi një gjyqtar të shkarkuar dhe t'i mbushi të gjithë me “shumë mirë”, “shumë mirë” dhe në ikje e sipër është dhe kur të vijnë ata të gjejnë...Do një riformulim kjo.

Gent Ibrahim – Do të doja të thosha që këtë çështje e kemi gjithandej me institucionet e reja që krijohen, është çështje e rëndësishme dhe pa dyshim nuk mund të hyjë në fuqi ligji që miratohet.

Nëse mund të kufizohen kompetencat, ndoshta një ide mund të ishte kjo që ata të vazhdojnë t'i ushtrojnë kompetencat sipas ligjeve të vjetra, por përmes procedurave të reja. Ky duhet të ishte një kufizim thelbësor i pushtetit të tyre, por ndërkohë do të diktonte një *modus operandum* të tyre, që është sipas standardeve të ligjit të ri.

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Zoti Ibrahim, në këtë propozim që ju bëtë të vazhdojnë të ushtrojnë kompetencat sipas ligjeve të vjetra, ligji i vjetër do të shfuqizohet me miratimin...

Fatmir Xhafaj – Kompetencat ekzistuese mund t'ia lësh ti në periudhë tranzitore. Nuk ka asgjë të keqe.

Gent Ibrahim – Idealisht kjo nuk duhet prekur fare, duhet lënë kështu siç është dhe ata duhet të vetëpërbahen. Është fiks si situata e qeverive teknike në pritje të zgjedhjeve të reja dhe të qeverive të legjitimuara. Në këtë garanci nuk e kemi. Skenari që përmendi zoti Xhafaj mund të ndodhë fare mirë dhe ata mund të zgjerohen në kompetenca, në kushte... Duhet ta shohim sesa e mundur është të bëhet kjo gjë.

Fatmir Xhafaj – Bëni një riformulim. Duhet ta kufizoni për një grup çështjesh të caktuara dhe me procedurën e re. Se mund të jetë një situatë që e vë këshillin dhe inspektorin e ri përballë shumë vështirësive.

Agnes Bernhard – (*flet përkthyesja*) Pra, në fakt, ky është një vendim politik, që vendoset nga politika, se ka një qasje të tillë, që të gjitha institucionet e reja që do të ngrihen, por që në fakt janë institucionet e vjetra, do të aplikojnë ligjin e ri. Kundërargumenti i kësaj është se ligji i ri përcakton rregulla më të qarta për këto institucione. Dhe alternativa e dytë do të ishte që të parashikonim një periudhë tranzitore deri sa të krijohen institucionet e reja dhe ata të aplikojnë parashikimet e këtij ligji, duhet të ndjekin rregullat e reja.

Fatmir Xhafaj – Interesante, edhe ata e ushtrojnë funksionin, por me procedurat e reja.

Agnes Bernhard – (*flet përkthyesja*) Kjo rregullohet me këtë dispozitë, ku parashikohet që institucionet ekzistuese duhet të fillojnë të aplikojnë ligjin e ri dhe jo më ligjin e vjetër. Por më vonë kemi parashikuar në dispozitat kalimtare disa masa sigurie, ku transferimet janë vetëm disa vendime paraprake dhe masa mbrojtëse. Dhe këshillat e rinj duhet t'i rishikojnë këto dhe më pas të marrin një vendim të prerë në mënyrë që të shmangim edhe abuzimet.

Fatmir Xhafaj – Me këtë logjikë që thoni ju, ka nevojë që kjo dispozitë të riformulohet. Dakord?

Duhet një dispozitë e formuluar me këtë konceptin që thatë ju.

Neni 161 “Dispozita kalimtare për magjistratët”.

Vasilika Hysi – Patëm një diskutim lidhur me vazhdimin në detyrë të kryetarit të gjykatës, nuk ka rëndësi nëse është kryetar gjykate, kryetar prokurorie etj. Diskutimi me zonjën Agnes ishte që të bëjmë një shtesë në këtë paragraf, sepse në rast se një gjyqtari i mbaron mandati 9-vjeçar, ai nuk mund të qëndrojë kryetar edhe 2 vjet plus.

(Mungesë audio)

Fatmir Xhafaj – Pse e komplikoni këtë gjë me këtë, edhe 2 vjet shtesë? “Një periudhë shtesë prej dy vjetësh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, kryetari në detyrë” Cili? Ose është paqartë, ose ai qëndron si kryetar edhe dy vjet dhe pastaj i nënshtrohet rizgjedhjes.

(Diskutim pa mikrofon)

Agnes Bernhard – Kushtetuta parashikon që kryetari i Gjykatës së Lartë ka një mandat 3 - vjeçar rizgjedhjeje dhe, duke u bazuar në dispozitat e kryetarit, duhet të rizgjidhet menjëherë.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 167 , “Dispozita kalimtare për gjykatat e krimeve të rënda”.

Vasilika Hysi – Neni 167 dhe neni... Më fal, ky nen është rregulluar. Pra, neni 162 është rregulluar...

Fatmir Xhafaj – Neni 162, por është shkruar gabim.

Vasilika Hysi - ... sipas dispozita kalimtare me ligjin e SPAK-ut. Zonja Agnes thotë që është konformë ligjit të SPAK-ut.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Të harmonizohet me ligjin përkatës që të mos kemi mbivendosje midis ligjit që kemi kaluar për SPAK-un dhe ligjin e statusit.

Neni 163 “Dispozita kalimtare për prokurorët e prokurorisë”.

Vasilika Hysi – Është e njëjta gjë, megjithatë duhet parë edhe varianti i fundit i ligjit të SPAK-ut që të jenë në harmoni.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, të harmonizohen të dyja ligjet.

Dakord.

Neni 164 “Dispozita kalimtare për magjistratët e gjykatave dhe prokurorive të tjera”.

Vasilika Hysi – Në fakt, në këtë nen thuhet: “Magjistratët janë subjekt i parashikimit të ligjit me hyrjen në fuqi të tij, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj”.

Pra, që në momentin e miratimit të ligjit magistratët bëhen subjekt i parashikimeve të këtij ligji.

Fatmir Xhafaj – Patjetër, subjekt i parashikimit të këtij ligji do të bëhen.

Vasilika Hysi – Pra, që në këtë moment mund të fillojnë transferimi, komandimi...

Fatmir Xhafaj – Jo. Ka këto...

Vasilika Hysi – Ndërkohë, do të doja, zoti kryetar, pasi kam pasur një diskutim sot me zonjën Agnes, në lidhje me parashikimin që bëhet në paragrafin 2, ku thuhet: “Magjistrati në detyrë, i cili është caktuar në pozicionin e...”

Fatmir Xhafaj – Paragrafi i parë nuk ka nevojë, sepse është i kuptueshëm pse duhet ta shtoni. Hiqeni pikën 1 nuk thotë ndonjë gjë, deri sa hyn ligji për ata hyn në fuqi.

Ju i referoheni pikës 2, pra duke hequr pikën 1 kjo mbetet me një pikë.

Vasilika Hysi – Po. Këtu thuhet: “Magjistrati në detyrë, i cili është caktuar në pozicion si magjistrat ose si kryetar qëndron në detyrë edhe në rastet kur ai nuk përmbush kriteret për të qenë kryetar të parashikuara në këtë ligj, vetëm në rastet kur ka shkaqe të mbarimit të statusit të magjistratit ose mandatit të tij”. Unë këtë nuk arrij ta kuptoj, si mund të qëndrosh në detyrë si kryetar edhe kur nuk i plotëson standardet?

Fatmir Xhafaj - Çfarë është kjo?

Vasilika Hysi – Më tej thuhet: “Mandati i kryetarit mbaron pas 4 vjetësh nga data e caktimit të tij si kryetar”.

Agnes Bernhard – *(flet përkthyesja)* Pika e parë që duhet saktësuar është për mandatin e kryetarit. Në fakt, mandati i kryetarit është i njëjtë sikurse edhe për kryetarin e Gjykatës së Lartë, por është bërë gabim për sa i përket periudhës, nuk duhet të jetë 4 vjet, por 3 vjet. Për sa i takon pikës së parë ligji është shkruar me qëllimin duke pasur parasysh ata magjistratë, prokurorë apo gjyqtarë që kanë kaluar përmes Shkollës së Magistraturës, por, meqenëse aktualisht kemi persona, të cilët nuk kanë kaluar përmes kësaj shkolle ata përsëri duhet të qëndrojnë në detyrë dhe mbase duhet hequr vetëm ajo pjesa e kryetarit që të mos konfuzohemi.

Fatmir Xhafaj – Atëherë, ndajeni në dy pika: çështja e magjistratëve që qëndrojnë në detyrë pavarësisht, siç e shpjeguat edhe ju, se nuk kanë bërë Shkollën e Magistraturës, por janë dhe do të qëndrojnë, si dhe çështja e kryetarit jo 2 vjet siç e ka kryetari i Gjykatës së Lartë, por 1 vit nga hyrja në fuqi. Pra, hiqet pika 1 dhe pika 2 që ju keni ndahet në pikë 1 dhe në pikë 2. Në rregull. Po.

Agnes Bernhard – *(flet përkthyesja)* Kjo dispozitë nuk e shtyn ose nuk i jep të drejtën për rizgjedhje kryetarit, por e parashikon vetëm që ai duhet të rrijë në këtë detyrë vetëm 3 vjet.

Fatmir Xhafaj – Më falni! Mund të rrijë 3 vjet, por atij mund t'i ketë mbaruar mandati edhe 6 muaj ka, si do të rrijë 3 vjet? Ta zgjasë mandatin? Ai mund të ketë edhe 1 vit dhe ne ia zgjasim me ligj mandatin.

Agnes Bernhard – *(flet përkthyesja)* Jo, atëherë ai duhet të zëvendësohet me dikë tjetër.

Fatmir Xhafaj – Prapë nuk del e qartë. Kështu siç thatë, ia jepni ju, ai mund të mos ketë dëshirë dhe ne i themi: jo do të rrih ti 3 vjet kryetar. Ai edhe 6 muaj mund të ketë si kryetar, prandaj kjo pjesë duhet saktësuar. Kryetarin e Gjykatës së Lartë e specifikuam dhe është normale se është autoritet, por edhe në rastin e autoritetit të kryetarit të gjykatës duhet specifikuar, sepse atij që i mbaron mandati i mbaron mandati, ne nuk ia shtojmë mandatin.

E lamë për ta riformuluar këtë dispozitë siç ramë dakord. Në rregull.

Neni 165 “Dispozita kalimtare për nxitësit ligjorë, këshilltarët dhe gjyqtarët dhe inspektorët jomagjistratë”.

Vasilika Hysi – Ky nen, zoti kryetar, garanton vazhdimësinë në detyrë të gjithë personave, qoftë këshilltarë në Gjykatën Kushtetuese, në Gjykatën e Lartë, në Prokurorinë e Përgjithshme, në Gjykatat Administrative, inspektor në Këshillin e Lartë të Drejtësisë me të vetmin përjashtim që për arsye ligjore ose për shkak të vlerësimit ata nuk...

Fatmir Xhafaj – Në rregull. Unë kam një merak që duhet të bëjmë një rregullim të posaçëm këtu, për ndihmësit ligjorë në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese, për arsye se mund të krijojmë një impas. Pra, mund të ikin të gjithë ata atje dhe të ngelet Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese pa ndihmës, prandaj na duhet një dispozitë që të bëjmë përjashtim nga ky rregull. Në rregull? Unë e kam një të gatshme, por gjithsesi ju mund ta ... të mos krijojmë vakuum. Çfarë ndodh? Të nesërmen del ky ligji, të gjithë ata shkojnë në shkollë dhe me kë do të punojë gjykata, edhe Gjykata e Lartë, gjithashtu? Kështu që na duhet një dispozitë tranzitore që ta njohë këtë gjendje, ta marrë në konsideratë që të mos krijohet vakuum. Dakord, zonja Agnes?

Dakord, për ta riparë me këtë logjikë.

Dakord me ndryshimet në nenin 165.

Neni 166 “Dispozitat kalimtare për gjyqtarë dhe prokurorë të mëparshëm ...”

Vasilika Hysi – Ky është një detajim i atij rregulli që parashikohet në aneksin e Kushtetutës, që kanë të drejtë të kandidojnë për të qenë prokurorë e gjyqtarë ish-prokurorët

dhe gjyqtarët, por konform kritereve që ka vënë Kushtetuta dhe këtu është një përsëritje e të gjitha kritereve të Kushtetutë, si dhe fakti që ata mund të kërkojnë vullnetarisht të bëjnë atë rivlerësimin për t'u kandiduar.

Fatmir Xhafaj – Pse e keni bërë këtë 9 vjet në 18 ditët e fundit? Unë e kuptoj 9 vjet, sepse është mandati i një gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, këtë e kuptoj. Po pse 18 dhe jo 20? A mund të ma thotë njeri këtë?

Mund të na thotë dikush: mos kanë pasur ndonjë në mendje deputetët atje që e kanë bërë 18, 17. Bëjeni 20. Mos e lidhni me Kushtetutën ju këtë?

Agnes Bernhard – *(flet përkthyesja)* Nuk ka pasur asnjë lloj arsytimi pse kemi vënë 18 apo 9-ën...

Fatmir Xhafaj – Bëjeni 20.

Agnes Bernhard – *(flet përkthyesja)* Mund ta bëjmë edhe 20 vjet, nuk ka ndonjë problem.

Fatmir Xhafaj – Edhe ne ta dimë që 20 vjetët e fundit, se janë të gjithë...

Gent Ibrahimi – Ideja është që të mos jetë shumë kohë larg funksionit të gjyqësorit se pastaj e harron atë, kjo është shumë e thjeshtë.

Fatmir Xhafaj – Po, ne po themi...

(Diskutime pa mikrofon)

Në rregull. Shiheni këtë në qoftë se ka nevojë për saktësim 9-ta dhe 18-ta, pasi mund të lindi ndonjë keqkuptim.

Agnes Bernhard – *(flet përkthyesja)* Do të doja të tërhiqja vëmendjen te paragrafi 3 i këtij neni në të cilin thuhet: “Këta persona duhet të konsiderohet që të riemërohen...”

Fatmir Xhafaj – Po.

Agnes Bernhard – *(flet përkthyesja)* Do të isha që fjala “konsiderohet” të hiqet. Ata thjesht përballen me këtë fakt që të kenë të drejtën për t'u riemëruar dhe të konsiderohen.

Fatmir Xhafaj – Në rregull. Në lidhje me pjesën: “Nuk ka mbajtur funksione politike në administratën publike ose funksione drejtuese në parti politike”, dakord për partitë politike, por funksione politike në administratën publike, pse jo? Ai ka qenë këshilltar në ministri për 10 vjet...

(Diskutime pa mikrofon)

Në rregull, por për t'u kthyer gjyqtar tani, nuk e di nëse ka apo nuk ka të tillë. Mund të ketë qenë, për shembull, këshilltar në Presidencë. Të paktën nuk ka mbajtur funksione politike për rreth 5 vjet, por në qoftë se ai ka qenë 2-3 muaj kjo gjë nuk ka kuptim.

Po, zonja Bernhard.

Agnes Bernhard – *(flet përkthyesja)* Reformulimi i është referuar edhe formulimit që është në Kushtetutë, pra të gjithë ata magjistratë, të cilët nuk kanë mbajtur një post politik për 10 vjet.

Fatmir Xhafaj – Ata janë për efekte karriere, jo për hyrjen në sistem...

Në rregull, të shihet atëherë me Kushtetutën, në qoftë se e ka Kushtetuta, pa diskutim, ne nuk kemi çfarë t'i bëjmë. Pra, të përputhet me parashikimet në Kushtetutë. Në rregull?

Dakord me ndryshimet që u bënë për nenin 166.

Neni 167 “Dispozita kalimtare për magjistratë të komanduar në struktura të tjera”.

Vasilika Hysi – Në fakt, kjo dispozitë i jep mundësinë një magjistrati, i cili ka një pozicion aktual i komanduar që nga ky moment me hyrjen në fuqi të ligjit, fillojnë e zbatohen këto lloj dispozitash.

Fatmir Xhafaj – Po mirë, sepse në Gjykatën e Lartë ka gjyqtarë që janë komanduar dhe bëjnë detyrën e këshilltarit sot. Siç e di unë, kemi pranë kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe ata nuk mund të digjen për këtë fakt.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, është bërë një shtesë që në rast se personi do ta presë periudhën e komandimit brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ai mund ta kërkojë që të mos vazhdojë më i komanduar ose nëse ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit...

Fatmir Xhafaj – Me aq sa unë di, në mos gaboj, nuk ka të tillë në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese. Ndoshta mund të ketë në ministri, në inspektim te KLD-ja mund të ketë të tillë, prandaj duhet zgjidhur periudha tranzitore e tyre, statusi në këtë periudhë.

Neni 168 “Dispozita kalimtare për inspektorët...”

Vasilika Hysi – Te neni 168 është një diskutim, i cili lidhet edhe me ligjin që diskutuam dje. Ne sot inspektorët i kemi dhe nuk i kemi magjistratë dhe me këtë dispozitë të gjithë inspektorëve u njihet statusi i magjistratit, edhe ata që nuk janë magjistratë aktualisht pranë Inspektoratit të Drejtësisë, i nënshtrohen procesit të rivlerësimit kalimtar gjyqtarë dhe prokurorë...

Fatmir Xhafaj – Jo, në të thuhet: “Inspektori dhe kryeinspektori në detyrë, të cilët kanë statusin e gjyqtarit...”, pra janë gjyqtarë, për ata është fjala. Apo e kam gabim? Ata që kanë statusin e gjyqtarit dhe kjo është e qartë nuk është për ata që nuk e kanë...

Vasilika Hysi – Mandati i tyre vazhdon deri sa të bëhen 5 vjet nga...

Fatmir Xhafaj – Këtë do ta lidhim me këshillin pastaj, me këshillin e ri dhe me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Dakord? Prandaj, le ta lidhim me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë afatin e përfundimit, siç kemi bërë edhe në ligjin për organizimin, sepse ai do ta çmojë nëse do ta mbajë ose jo inspektor, në rastin tjetër do të shkojë gjyqtar. Në rregull?

Dakord me ndryshimin? Po.

Neni 169 “Dispozita kalimtare për të drejtat dhe detyrimet e magjistratëve”.

Vasilika Hysi – Kjo dispozitë duhet riparë, sepse në të thuhet: “Të gjitha të drejtat dhe detyrimet zbatohen menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij ligji”. Në fakt, nuk mund t’i fillosh që tani të gjitha të drejtat dhe detyrimet, sepse këtu përfshihet edhe paga. Kur thuhet: “menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij ligji, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë nen...”, duhen bërë disa dallime. Në qoftë se te nenet ose në pikat e këtij neni ka diferencim te pagat, të drejtat e tjera...

Fatmir Xhafaj – Po mirë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë nen, në këtë ligj...

Vasilika Hysi – Jo, e kam me këtë nen, se nuk është vetëm paga, sepse në këtë nen thuhet se kur do të fillojnë efektet e pagës dhe të përfitimeve. Po të drejtat e tjera? Po biem në kontradiktë me atë që thamë transferimi, emërimi, promovimi këto janë të drejta dhe detyrime të magjistratit, nga njëra anë themi që do t’i lidhim, do të kemi një periudhë tranzitore dhe nga ana tjetër themi që këto të drejta dhe detyrime fillojnë menjëherë të zbatohen.

(Diskutime pa mikrofon)

Paragrafi i parë i nenit 169.

Fatmir Xhafaj – Pra, jo “në këtë nen”, por mund ta lëmë “në këtë ligj” dhe ku kemi bërë parashikime t’i bëjmë ato.

(Diskutime pa mikrofon)

Pra: “Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj”, dhe i vendosni rast pas rasti. Dakord?

Agnes Bernhard – *(flet përkthyesja)* Ky nen i referohet vetëm kapitullit që ka të bëjë me të drejtat dhe detyrimet jo me ato të tjerat që ju i përmendët më përpara, të cilat janë transferimet apo riemërimet. Për këtë arsye aty është thënë: “Nëse parashikohet ndryshe në këtë nen”, i cili lidhet vetëm me të drejtat dhe detyrimet. Për sa i përket pagës kemi dispozita të veçanta në paragrafët 5 dhe 6.

Fatmir Xhafaj – Dakord, do ta çojmë në 1 janar të vitit 2019, sepse kemi 2 vjet për të mbyllur procesin e me radhë.

Vasilika Hysi – Zonja Agnes, në pikën 5 të nenit 169 ju i referoheni kreut 3. Në kreun 3, flitet caktimi në pozicion, caktimi i përkohshëm, pra po ta shihni kreu 3 nuk është thjeshtë kreu për pagat. Unë shoh se janë gjitha të drejtat...

Agnes Bernhard – (*flet përkthyesja*) Është bërë gabim në referencë, duke iu referuar gabimisht atij kapitulli. Duhet t'i referohemi vetëm kapitullit që ka të bëjë me të drejtat dhe përfitimet.

Fatmir Xhafaj – Ka të drejtë, zoti Vasili, rishiheni që të kemi referenca të sakta dhe të vëmë këtu 1 janarin e vitit 2019. Dakord?

Atëherë, neni 169 të riformulohet, meqenëse edhe ju vetë e pranoni se ka pasaktësi në referenca, si dhe pikën 5.

Pika 6 nuk është e nevojshme të shihet, kur të marrim pagat t'i marrim të gjitha. Do të fillojmë të bëjmë edhe rimbursime ne tani? Hiqeni pikën 6.

Etilda Saliu – Koncepti është se, meqë në fillim është lënë afati 1 janar 2018 dhe, meqenëse jo të gjithë mund të shkojnë në procesin e rivlerësimit brenda kësaj kohe, pra procesi i rivlerësimit të përfundojë deri në 1 janar të vitit 2018, u la që ata të cilët kalojnë rivlerësimin...

Fatmir Xhafaj – Kalojeni me një riformulim më të thjeshtë se me rimbursim. Ata që kanë kaluar anëtarë nga 1 janari i vitit 2019 marrin pagat e reja me sistemin e ri të rivlerësuar, kaq. Jo rimbursohet, jo nuk rimbursohet, jo para periudhës, rimbursohet me këtë periudhë...

Ne i kemi pasur me paga minimale, menjëherë për 2 vjet do të varfërohen ata.

(Diskutime pa mikrofon)

Mirë e ka zoti Vasili, më të varfër seç janë nuk bëhen, kjo është e sigurt.

Neni 169 të riformulohet, me ndërhyrjet që u bënë.

Neni 170 “Dispozita kalimtare në lidhje me fazën e rekrutimit të kandidatëve magjistratë”.

Dakord.

Ju lutem, saktësoni referencat!

Neni 171 “Dispozita kalimtare për emërimet”.

Dakord.

Neni 172 “Dispozita kalimtare me ndryshimet”.

Dakord.

Pra: “Dispozita kalimtare për caktimin në pozicionin e magjistratit të emëruar”. Ju lutem, riformulimet me referencat!

Neni 173 “Dispozita kalimtare për transferimin dhe ngritjen në detyrë”.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, ndjesë! Neni 172 është lidhur me 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Pra, përsëri parashikimet e kreut 3, titulli 3...

Fatmir Xhafaj – Ju mund të bëni referencat.

Vasilika Hysi – Jo, promovimet, transferimet brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Fatmir Xhafaj – Nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, lidheni me atë. Kemi kaq ditë që jua themi këtë gjë, lidheni me Këshillin dhe ai të marrë të gjitha përgjegjësitë në sistemin e ri të vlerësimit, është një sistem totalisht i ri. Prandaj, ai do të marrë përgjegjësitë, do t’i bëjë aktet nënligjore të zbatueshme. Për 6 muaj...

(Diskutime pa mikrofon)

Më falni, pa punë do t’i lërë ai ata. Po çdo lloj afati është i gabuar. Më fal, në qoftë se ai është diplomuar dhe ka marrë diplomën e Shkollës së Magjistraturës nuk do të emërohet për 2 muaj?

(Diskutime pa mikrofon)

Shiheni që të lidhen me këshillin këta...

(Diskutimi pa mikrofon)

Petrit Vasili – Në ligj thuhet: “Këshilli me vendim cakton pozicionin e magjistratit brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit”. Ne nuk e dimë nëse e ngremë dot këshillin brenda 3 muajve.

Vasilika Hysi – Unë flas për atë që është ekzistues.

Petrit Vasili – Ne thamë që nuk duam t’ia lëmë këtë kompetencë.

Vasilika Hysi – Po.

Petrit Vasili – Ne folëm për këtë gjë.

Fatmir Xhafaj – Atëherë, dakord me ndryshimet? Pra, te nenet 171, 172 dhe 173 të replikohet e njëjta logjikë, e cila lidhet me këshillin?

Dakord me ndryshimin.

Neni 174 “Dispozita kalimtare për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve”.

Vasilika Hysi – Unë kam një sugjerim, të cilin e kam diskutuar edhe me ekspertët. Në pikën 4 thuhet: “Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë i dërgon Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dosjen duke përfshirë projekt-raportet e vlerësimit”. Në fakt, këshillat nuk mund të bëjnë gati projekt-raportin e vlerësimit që i takon të bëjë komisionit të pavarur të kualifikimit, por ato i dërgojnë të gjitha informacionet, siç ia dërgon ILDKPIA-ja dhe të gjitha institucionet e tjera...

Fatmir Xhafaj – Dosjen e vlerësimit do të japë.

Petrit Vasili – Të themi “i përcjell komisionit”, pra vetëm bën transportin.

Agnes Bernhard – (*flet përkthyesja*) Do të sugjeroja që të shtonim një fjali tjetër për të qenë edhe më të sigurt: “Këshilli duhet të japë jo vetëm raportin e vlerësimit, por edhe çfarëdolloj dokumenti tjetër shtesë që komisioni i pavarur i kërkon”.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Dakord me ndryshimet.

Neni 175 “Dispozita kalimtare për procedime disiplinore”.

Dakord.

Neni 176 “Aktet nënligjore”.

Vasilika Hysi – Tek aktet nënligjore ka shumë akte, të cilat duhet të nxirren nga institucione të ndryshme dhe mendoj se duhet të shohim periudhën se kush do t’i nxjerrë aktet. Një pjesë e akteve nxirren me krijimin e këshillit. Për shembull, Këshillit të Ministrave i është vënë një afat 3 muaj nga hyrja në fuqi, prandaj ne duhet t’i saktësojmë mirë të gjitha aktet. Në bazë të teknikës legislative duhet përcaktuar që këshillat 3 muaj nga ngritja e tyre nxjerrin akte në mbështetje, për shembull, të nenit 18, 19, është rregull.

Petrit Vasili – Edhe Këshilli i Ministrave e ka këtë detyrim. Miraton akte nënligjore lidhur me kë? Çfarë detyrimesh ka Këshilli i Ministrave lidhur me këtë ligj? Ku do t’i nxjerrë aktet. Për kë? Atëherë 1, 2, 3 dhe 4 se është shumë e përgjithshme dhe ky është një detyrim. Kurrkush nuk mund t’i thotë Këshillit të Ministrave apo kujt do tjetër: çfarë nuk ke nxjerrë. Ke pasur detyrim të nxjerrësh këtë në bazë të nenit kaq, pika kaq zberthehet me akt të qeverisë. Kjo duhet bërë patjetër.

Fatmir Xhafaj – Është shumë e rëndësishme që në respektim të nenit 118 të Kushtetutës, ligji duhet të përcaktojë nenet në bazë dhe për zbatim të të cilave do të miratohen aktet nënligjore.

Petrit Vasili – Kisha edhe një pyetje të vogël dhe nuk kam asgjë tjetër. Në nenin 176 thuhet: “Këshilli i Ministrave përditëson aktet nënligjore brenda 3 muajve... bazuar në nenin 18, pika 7 e këtij ligji”. Neni 18 nuk ka 7 pika, është vetëm një nen, pa asnjë pikë.

Etilda Saliu – Janë ndryshuar referencat, prandaj duhet riparë.

Fatmir Xhafaj – Duhet të rregullohen të gjitha referencat dhe duhet thënë: neni kaq në zbatim me këtë, në zbatim të kësaj e me radhë...

Petrit Vasili – Edhe kështu siç është, neni 18 thotë: “Rregullat për pagat dhe përfitime të tjera financiare”, nuk ka pika fare, vetëm kaq është një fjali.

Fatmir Xhafaj – Janë të gjitha për pagat dhe ju duhet t’i nxirni, të DAP-it...

Vasilika Hysi – Kjo është, zoti kryetar, pasi të numërtohen, sepse ka ndryshime të numërtimit të neneve, do të dalë për çdo nen detyrimi që ka, qoftë Këshilli i Ministrave, qoftë këshillat përkatëse. Është rregull i teknikës legjislative.

Fatmir Xhafaj – Hyrja në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Dakord.

Në tërësi, dakord? Po.

Ju lutem, bëni plotësimet, zbardhjet, të gjitha!

(Diskutime pa mikrofon)

E kemi këtu.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, miratimi i këtij ligji sjell si detyrim ndryshime në ligjet e tjera, por edhe shfuqizime të ligjeve.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, do t’i bëjmë ne ato.

Vasilika Hysi – Ne duhet themi: “Në një dispozitë kalimtare”, sepse ky këtu është ligj i ri.

Fatmir Xhafaj – Brenda kaq kohësh duhen bërë ndryshimet në këtë dhe këtë...

Vasilika Hysi – Po. Kemi edhe shumë ligje të tjera, kemi ndryshime në ligjin e pensioneve, ndryshime në ligjin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë...

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Vasilika Hysi – Gjithandej ka ndryshime.

Fatmir Xhafaj – Ti parashikojmë...

U votuan, prandaj të zbardhen për t’i saktësuar gjërat që të jenë gati për seancë. Ndërkohë, të hënën është ligji “Për Gjykatën Kushtetuese” dhe këtu mbyllet paketa.

Faleminderit!

Faleminderit për ndihmën!

Faleminderit, zonja Bernhard!

MBYLLET MBLEDHJA

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

